

Raporti Vjetor i Monitorimit 2023

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR
PUSHTETIN VENDOR



Tabela e përmbajtjes

HYRJE	5
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2. INFORMACION MBI PROCESIN E PËRGATITJES SË RAPORTIT	10
2.1 METODOLOGJI	10
2.2 QASJA ANALITIKE E STRUKTURUAR BAZUAR NË EVIDENCA DHE KONSULTIM	10
2.3 PROCEDURA PËR ANALIZIMIN E TË DHËNAVE PËR RAPORTIN E MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS	11
2.4 PROCEDURA PËR ANALIZIMIN E RISKUT	11
2.5 PJESËMARRJA E AKTORËVE NË PËRGATITJEN E RAPORTIT DHE SHKALLA E PËRGJIGJEVE.....	12
3. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI ECURINË E ZBATIMIT TË STRATEGJISË	14
4. ANALIZË E ARRITJEVE	16
4.1 ZBATIMI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT	16
4.2 NIVELI I PËRGJITHSHËM I RISKUT.....	17
4.3 ANALIZA E PROGRESIT TË INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS	18
5. ANALIZA E PROGRESIT DREJT QËLLIMEVE POLITIKE (6 SHTYLLAVE TË STRATEGJISË)	21
5.1 QP1: FORCIMI DHE NXITJA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM VENDOR	21
5.2 QP2: PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE VENDORE ME QËLLIM RITJEN E CILËSISË DHE STANDARDIT TË OFRIMIT TË TYRE PËR QYTETARËT	26
5.3 QP3: DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE VENDORE DHE PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË OFRIMIT TË TYRE	37
5.4 QP4: FORCIMI I FINANCAVE VENDORE DHE AUTONOMISË FISKALE	39
QP 5: PËRMIRËSIMI I DEMOKRACISË VENDORE DHE AVANCIM I AGJENDËS SË INTEGRIMIT EVROPIAN NË NIVEL VENDOR	42
5.6 QP6: ZHVILLIMI DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË NEVOJSHME VENDORE DHE QENDRORE DHE I NJË KOORDINIMI E QEVERISJEJE FUNKSIONALE GJITHËPËRFSHIRËSE TË AKTORËVE TË DECENTRALIZIMIT.....	45
REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE	51

Lista e figurave

Figura 1: Progresi në realizim i Strategjisë sipas Qëllimeve Politike (% masave sipas statusit të zbatimit).....	9
Figura 2: Tabela e vlerësimit të riskut	12
Figura 3: Ecuria e Indikatorëve të Performancës.....	20
Figura 4: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP1	21
Figura 5: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP2	27
Figura 6: Statusi i zbatimit të dy objektivave specifike në QP3	37
Figura 7: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4	39
Figura 8: Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike në QP5.....	43
Figura 9: Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike të QP6.....	45
Figura 10: Përmbledhëse e statusit të 22 objektivave specifike.....	50
Figura 11: Informacion i përgjithshëm mbi realizueshmërinë e masave	52

Lista e tabelave

Tabela 1: Zbatimi i masave në numër dhe përqindje	7
Tabela 2: Zbatimi i masave në numër dhe përqindje	14
Tabela 3: Numri i masave të zbatuara për qëllim politik.....	15

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit.....	7
Grafiku 2: Qëllimet politike sipas përqindjes së realizimit të objektivave specifike	8
Grafiku 3: Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit	14
Grafiku 4: Realizueshmëria e masave për qëllim politik.....	15
Grafiku 5: Niveli i realizimit të masave sipas objektivave për çdo qëllim politik	16
Grafiku 6: Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit sipas gjashtë qëllimeve politike.....	17
Grafiku 7: Niveli mesatar i riskut për çdo objektiv specifik.....	18
Grafiku 8: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP1	22
Grafiku 9: Zbatueshmëria e masave të QP1	22
Grafiku 10: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP2	27
Grafiku 11: Zbatueshmëria e masave të QP2	28
Grafiku 12: Statusi i zbatimit të dy objektivave specifike në QP3	37
Grafiku 13: Zbatueshmëria e masave të QP3	38
Grafiku 14: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4	39
Grafiku 15: Zbatueshmëria e masave të QP4	40
Grafiku 16: Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike të QP5.....	43
Grafiku 17: Zbatueshmëria e masave të QP5	44
Grafiku 18: Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike në QP6.....	46
Grafiku 19: Zbatueshmëria e masave të QP6	46
Grafiku 20: Totali i objektivave specifike	50

Lista e shkurtimeve

AFMIS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Financave
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
BPE	Bashki Për Evropë
BtF	Bashki të Forta
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPMZSH	Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
DPTH	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
KB	Këshilli Bashkiak
KE	Këshilli i Europës
KK	Këshilli Konsultativ
KKDM	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
KM	Këshilli i Ministrave
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Inovacionit dhe Energjisë
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Referimit të Rasteve
OS	Objektiv Specifik
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PE	Parlamenti Evropian

PKIE	Plani Kombëtar i Integritimit Evropian
Pp	Pikë Përqindje
PVKM	Projektvendim i Këshillit të Ministrave
QP	Qëllim Politik
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TAP	Tatimi i të Ardhurave Personale
TP	Tregues Performace
UK	Ujësjellës-Kanalizime
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Hyrje

Raporti i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, dhe planit të veprimit të saj 2023-2025, u përgatit nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me mbështetjen dhe ekspertizën teknike të ofruar nga organizata “FLAG”.

Përgatitja e këtij raporti është detyrë funksionale e AMVV në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 227, datë 09.04.2024, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”. Ky është viti i parë i monitorimit, i cili do të kryhet periodikisht me një frekuencë një vjeçare, bazuar në informacionin që do të përcillet nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në këtë strategji. Është e rëndësishme të theksojmë që cilësia e përmbajtjes dhe detajeve të paraqitura në raportin e monitorimit, varet nga niveli i informacionit dhe përcjelljes së tij nga institucionet qendrore si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Vizioni për qeverisjen vendore dhe decentralizimin është rruga drejt një qeverisje autonome e cila promovon vlera demokratike, orientohet drejt rritjes ekonomike dhe ushtrimit të funksioneve bashkiake në mënyrë eficiente. Duke integruar elementin gjinor në strategji sigurohet që politikat dhe ligjet t’i përgjigjen nevojave të gjithë komunitetit duke marrë në konsideratë përfaqësimin, përfshirjen dhe marrjen e masave kundër pabarazive.

Në kuadër të arritjes së vizionit të kësaj strategjie janë ngritur gjashtë qëllime politike.

1. Nxitja dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Ky qëllim synon të përforcojë dhe të mbështesë rolin e bashkive dhe këshillave të qarqeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor, duke i’u dhënë instrumentet dhe hapësirën e duhur për të vënë në përdorim asetet natyrore, ekonomike e kulturore.

2. Përmirësimi i cilësisë, standardeve dhe i ofrimit të shërbimeve vendore.

Ky qëllim konsolidon rolin e NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve dhe një zbatim efikas të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore institucionale, si dhe duke përmirësuar shërbimet në mënyrë sa më eficiente e të njëjtë te qytetarët për një forcim të performancës së qeverisjes vendore.

3. Zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë eficiente, transparente dhe me kosto efektive.

Ky qëllim synon avancimin e agjendës së digjitalizimit, duke përmbushur nevojat e komunitetit për shërbime më të shpejta dhe në kohë më të shkurtër.

4. Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta.

Ky qëllim përcakton financat vendore si një nga shtyllat më të rëndësishme, pasi nëpërmjet fuqizimit të gjendjes financiare, bashkitë krijojnë mundësinë e kryerjes së funksioneve dhe kompetencave, në të gjithë territorin.

5. Përmirësimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor.

Ky qëllim ka në fokus forcimin e mirëqeverisjes në nivel vendor, nxitjen e politikave kundër korrupsionit, përparimin e agjendës së integritit evropian si dhe forcimin e rolit të qeverisjes vendore në zbatimin e politikave për të dhënë shërbime me transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve.

6. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit.

Ky qëllim synon përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve administrative duke mundësuar rekrutime cilësore të burimeve njerëzore, evidentim të nevojave për trajnim lidhur me proceset e reja që NJVV-të do të jenë përgjegjëse të kryejnë në kuadër të procesit të integritit.

1. Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2023-2030, e miratuar në muajin Prill 2023, mbylli vitin e parë të planit të veprimit 2023-2025, duke hyrë në vitin e dytë të zbatimit të saj. Ky raport monitorimi paraqet ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë si edhe produkteve specifike. Niveli i zbatimit për vitin 2023, do të shërbejë si bazë krahasimore për raportet e monitorimit të viteve 2024 dhe 2025.

Bazuar në metodologjinë e hartimit të raportit, fokusi kryesor i tij është në evidentimin e produkteve të arritura në kuadër të masave për objektiv specifik. Një element plotësues i ecurisë së agjendës së decentralizimit është edhe pasaporta e indikatorëve me treguesit e performancës.

Ecuria e zbatimit të masave të parashikuara në strategji është në nivele të kënaqshme duke konsideruar faktin që jemi në vitin e parë të monitorimit. Nga 158 masa të caktuara në planin e veprimit për tu monitoruar për vitin 2023, rreth 22% e tyre mund të konsiderohen të realizuara në vlerën 100% duke iu përmbajtur afatit kohor të planit të veprimit (35 masa).

Grafiku 1: Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit





Tabela 1: Zbatimi i masave në numër dhe përqindje

Statusi i masave	Numri i Masave	Përqindja e Masave
Masa të zbatuara 100%	35	22%
Masa të zbatuara 51%-99%	46	29%
Masa të zbatuara 6%-50%	51	32%
Masa pa filluar zbatimin 0%-5%	26	16%
Totali i masave	158	100%

Nga një vështrim i përgjithshëm nga 158 masa vërejmë se 35 masa janë zbatuar në nivelin 100%, 46 masa janë zbatuar në nivelin 51%-99%, 51 masa janë në proces realizimi dhe për 26 masa nuk ka filluar ende zbatimi ose përqindja e zbatimit është shumë e ulët.

Për sa i përket 6 qëllimeve politike kanë patur një ecuri të tillë ku, qëllimi politik nr.1 në zbatimin gjithsej të masave shënon rezultatin prej 51%, qëllimi nr.2 shënon një nivel realizimi prej 53%, qëllimi nr.3 nivel realizimi prej 60%, qëllimi nr.4 nivel realizimi prej 43%, qëllimi politik nr.5 nivel realizimi prej 66%, ndërsa qëllimi politik nr.6 shënon rezultat më të dobët me 30% krahasuar me qëllimet e tjera për sa i përket zbatimit të masave.

Grafiku 2: Qëllimet politike sipas përqindjes së realizimit të objektivave specifike



Rezultatet kryesore të arritura në vitin parë të zbatimit të Strategjisë janë:

1. Përbushja në masën 66% e qëllimit politik nr.5. Ky rezultat evidenton vullnetin e institucioneve përgjegjëse për përmirësimin e parametrave të demokracisë vendore dhe zgjerimin e rolit të bashkive në procesin e integrimit evropian.
2. Në vitin e parë të monitorimit të strategjisë vihet re ripozicionimi i NJVV-ve në lidhje me zhvillimin ekonomik vendor. Në krahasim me periudhën paraardhëse, bashkitë kanë nisur procesin e rivitalizimit të aseteve të tyre në funksion të rritjes ekonomike të tyre.
3. Zhvillimi i trajnimeve rajonale dhe lokale në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Me këtë rezultat evidentohet një vëmendje e shtuar e NJVV-ve për fuqizimin e administratës së tyre.

Vlejnë të përmenden sfidat e hasura në zbatimin e planit të veprimit gjatë vitit të parë të raportimit:

1. Forcimi i rolit të Grupit Tematik të Decentralizimit në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët.
2. Vëmendja e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit. Rasti konkret është qëllimi politik nr.6 me rezultatin e prodhuar. Ky instrument do t'i shërbejë orientimit të detajuar për zhvillimin e mëtejshëm të pushtetit vendor.
3. Parashikimi i përgjegjshëm buxhetor i institucioneve përgjegjëse për zbatimin me sukses të strategjisë.

Realizimi i Strategjisë sipas Qëllimeve Politike




Figura 1: Progresi në realizim i Strategjisë sipas Qëllimeve Politike (% masave sipas statusit të zbatimit)

2. Informacion mbi procesin e përgatitjes së raportit

2.1 Metodologji

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e Strategjisë, Planit të Veprimit të saj, sa i përket masave, indikatorëve të performancës dhe financimit të saj. Në zbatim të VKM Nr.227, datë 09.04.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, është miratuar me urdhërin e Kryeministrit nr.83, datë 20.05.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”. Sektori i Decentralizimit pranë Drejtorisë së Kuadrit Ligjor dhe Decentralizimit është njësi përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2023 - 2030.

Ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë ngarkuar për të garantuar zbatimin e masave dhe objektivave, si edhe dhënien e informacionit të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Referuar Planit të Veprimit 2023–2025, NJVV janë përgjegjëse për zbatimin e 40 masave, ndërsa përgjegjëse kryesore janë për 27 masa. Kostot indikative të parashikuara për zbatimin e këtyre masave për vitet 2023–2025 janë 3.921.658.691 Lekë, nga të cilat 87% përballohet nga PBA-të e NJVV dhe 4% nga donatorët. Hendeku financiar, pjesa e pafinancuar e zbatimit të masave përbën 9% të totalit. Institucionet qendrore janë ngarkuar me përgjegjësi kryesore për zbatimin e 152 masave të Planit të Veprimit të Strategjisë me kosto indikative 6.139.400.017 Lekë, nga të cilat 84% përballohen nga PBA-të e institucioneve përgjegjëse dhe 15% nga donatorët. Hendeku financiar përbën 2% të totalit.

Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNDQV) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuese të planit të veprimit. Raporti fokusohet në një panoramë të gjerë në analizën e funksioneve dhe shërbimeve kryesore të NJVV-ve dhe institucioneve qendrore, si dhe në analizën dhe treguesit financiarë të tyre.

Këto raporte janë vjetore, dhe ofrojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNDQV-së për vitin e ardhshëm.

2.2 Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim

Vlerësimi i ecurisë së Qëllimeve Politike dhe Objektivave Specifikë bazohet në ecurinë e raportuar të nivelit të zbatimit, financimit dhe riskut të masave që përmban secili objektivi nga institucionet përgjegjëse. Përcaktimi i statusit të progresit të secilit objektivi bazohet në kodet dhe pragjet e përcaktuara nga Guida e Mirëqeverisjes si vijon:

- Dobët—kur vetëm 0-5% masave të planifikuara janë realizuar,
- Mirë—kur 6-50% masave të planifikuara janë realizuar,
- Shumë mirë —kur 51-100% masave të planifikuara janë realizuar.

Nivelet e vlerësimit të progresit me zbatimin e masave nga institucionet qendrore dhe niveli i riskut janë bazuar në Guidën Metodologjike të Kryeministrit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale. Masat të cilat kanë kohështrirje disavjeçare, janë parashikuar me intensitet konstant zbatimi dhe pritshmëri realizimi të plotë në fund të periudhës së zbatimit.

Masat në përgjegjësi zbatimi nga NJVV-të, parashikohen të realizuara plotësisht kur realizimi përmbushet nga disa bashki, ku shënohet një model pikënisjeje për aktivitetin e caktuar. Në rastet kur përgjegjësia e zbatimit dhe e raportimit të masës është e ndarë mes institucioneve qendrore dhe vendore, paraqitja grafike është bazuar në raportimin e institucionit qendror dhe rezultati është krahasuar grafikisht dhe interpretuar në objektivin përkatës.

2.3 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- E zbatuar: Është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa/produkte të cilat janë përmbushur;
- Pjesërisht e zbatuar/Në proces: Është raportuar statusi “Në proces” për ato masa/produkte, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre;
- E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa/produkte të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Pasaporta e indikatorëve të performancës është vlerësuar duke i krahasuar vlerat e raportuara aktuale për vitin e raportimit, me vlerën e synuar në vitin përkatës. Për vitin 2023 raportohet tendenca vetëm për ato tregues që kanë të përcaktuar vlerën bazë në dokumentin e Strategjisë, ose në formatet e raportimit të shpërndara Ministrive, ku është kërkuar plotësimi i të dhënave për vitin 2022 në rastet kur mungon. Raportimi i viteve 2024 dhe 2025, do të përfshijë dhe ecurinë krahasimore të progresit me vitin pararendës.

2.4 Procedura për analizimin e riskut

Shkalla e përdorur për identifikimin e risqeve në nivel politik dhe objektivi specifik është në zbatim të Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Vlerësimi i riskut është matur sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. Bazuar në keto specifika risku bie në një nga tre zonat:

- Risk i ulët që konsiderohet i pranueshëm (Ngjyra jeshile, nr.1),
- Risk i lartë që konsiderohet i papranueshëm (Ngjyra e kuqe, nr.3),
- Risk i moderuar që mund ose nuk mund të jetë i pranueshëm (Ngjyra e verdhë, nr.2).

Figura 2: Tabela e vlerësimit të riskut

Mundësia	E lartë	2	3	3
	Emesme	1	2	3
	E ulët	1	1	2
		E ulët	E mesme	E lartë
Impakti				

Figura 2 tregon se si janë të paraqitura grafikisht nivelet e riskut për çdo masë.

2.5 Pjesëmarrja e aktorëve në përgatitjen e raportit dhe shkalla e përgjegjeve

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft formularit, AMVV dërgoi dokumentin në datë 08.04.2024, institucioneve qendrore për konsultim përpara finalizimit të produkteve dhe pyetësorit që lidheshin me formatin e raportimit. Në përfundim të procesit konsultues AMVV kreu reflektimin e komenteve dhe sugjerimeve.

Në datën 23.04.2024 u dërgua pyetësori për plotësim pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe më datë 30.04.2024 ministrive të linjës. Bashkëlidhur udhëzimeve është dërguar pyetësori në formatin excel si dhe linku për plotësimin e të dhënave në google form.

Mbledhja e të dhënave nga pyetësorët është një ndër fazat më të rëndësishme të procesit të monitorimit të Strategjisë së Decentralizimit. Këto të dhëna nga Institucionet Qendrore dhe 61 bashkitë përbëjnë burimin parësor për monitorimin e masave, treguesve dhe objektivave financiarë.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë plotësuar pyetësorin e përgatitur me produktet specifike për çdo masë (konkretisht 40 masa të konvertuara në 60 pyetje. Në këtë proces fillimisht është plotësuar formati excel, i shpërndarë nga personat e kontaktit të caktuar për raportimin në bashki sipas drejtorive përkatëse. Të dhënat e gjeneruara nga sektorët dhe drejtoritë përgjegjëse për raportim pranë bashkive janë hedhur në formatin google form si metoda e rekomanduar më e përshtatshme për një analizë të thellë të të dhënave të mbledhura.

Ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore kanë ndjekur në mënyrë të ngjashme metodën e NJVV-ve, me ndryshimin që pyetësorët e tyre ishin specifik për masat e çdo institucioni. Fillimisht u përdor e njëjta mënyrë mbledhjeje e të dhënave nëpërmjet google form

e cila nuk solli rezultatet e pritshme, pasi këto institucione përzgjedhën plotësimin e pyetësorëve në format excel. Si rrjedhojë edhe mënyra e analizimit dhe përpunimit të të dhënave ka ndjekur një procedurë tjetër që t'i përshtatej mbledhjes së të dhënave.

Si një fazë kyçe, grumbullimi i të dhënave ka qenë një nga sfidat kryesore të gjithë procesit të krijimit të raportit, kjo për shkak të vonesave në dorëzimin e pyetësoreve nga të dyja palët, si Ministrinë e Linjës ashtu edhe prej NJVV-ve.

Shkaqet për këto problematika kanë qenë të ndryshme duke marrë parasysh ngarkesën në detyrat e përditshme të NJVV-ve, si edhe të raportimeve dhe kontrolleve nga organet audituese që mund të kenë pasur paralelisht me pyetësorin e monitorimit të strategjisë. Me gjithë sfidat, me rëndësi është arritja e rezultatit maksimal në grumbullimin e këtyre të dhënave nga bashkitë e tjera, ndërsa për sa i përket saktësisë së tyre, kjo mbetet për t'u përmirësuar në vitet e ardhshme të realizimit të raportit.

Për sa i përket Ministrive të Linjës dhe Agjencive të tyre, problematika e vetme në vonesën e plotësimit të të dhënave ka ardhur si pasojë e largimit nga institucioni të punonjësve që kanë qenë pjesë e grupit të punës të hartimit të strategjisë.

Në përfundim të procesit të mbledhjes së të dhënave, informacioni u sigurua nga 61 NJVV, dhe nga 17 Institucionet Qendrore, të gjitha kanë raportuar duke e siguruar informacionin.

3. Vlerësim i përgjithshëm mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) përfundon vitin e parë të monitorimit për vitin 2023, në Qershor 2024. Ky raport monitorimi paraqet ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë 2023-2025 duke përcaktuar statusin e masave dhe objektivave specifikë. Plani i veprimit për vitin 2023 përfshin 158 masa, 22 objektiva dhe 13 indikatorë performance. Për 132 masa nga 158 që e kanë vitin e nisjes në 2023, tashmë ka filluar zbatimi, nga të cilat 35 prej tyre janë realizuar brenda periudhës së parashikuar në planin e veprimit. Disa masa kanë përfunduar procesin e realizimit dhe nxjerrjes së produktit ndërsa pjesa tjetër janë drejt përfundimit, 46 masa janë në kohë për t'u plotësuar, 51 masa janë mbrapa afatit në lidhje me procesin e realizimit, ndërsa 26 masa nuk kanë filluar akoma zbatimin e tyre.

Grafiku 3: Numri i masave të planit të veprimit sipas përqindjes së zbatimit




Tabela 2: Zbatimi i masave në numër dhe përqindje

Statusi i masave	Nr. masave	% masave
Masa të zbatuara 100%	35	22%
Masa të zbatuara 51%-99%	46	29%
Masa të zbatuara 6%-50%	51	32%
Masa pa filluar zbatimin 0%-5%	26	16%
Totali i masave	158	100%

Referuar grafikut 4, në nivel qëllimesh politike progresi më i lartë shihet në shtyllën e dytë lidhur me përmirësimin e cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore, e cila ka edhe numrin më të lartë të masave të realizuara për periudhën e raportimit. Kjo shtyllë ka edhe numrin më të madh të masave për qëllim politik krahasuar edhe me shtyllat e tjera. Gjithashtu

në një ecuri pozitive përtej pritshmërive ndodhet edhe shtylla e parë e cila lidhet me promovimin dhe forcimin e zhvillimit të qendrueshëm vendor.

Grafiku 4: Realizueshmëria e masave për qëllim politik




Tabela 3: Numri i masave të zbatuara për qëllim politik


Qëllimet politike	Masa 100%	Masa 51%-99%	Masa 6%-50%	Masa 0%-5%
QP1: Promovimi dhe forcimi i zhvillimit të qendrueshëm	7	9	9	3
QP2: Përmirësimi i cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve	19	18	24	5
QP3: Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre	2	0	4	6
QP4: Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta	2	9	7	3
QP5: Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor	3	3	1	1
QP6: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve	2	7	6	8
Totali i masave	35	46	51	26

4. Analizë e arritjeve

Duhet të theksojme se në nivel objektiv specifik, duhet të kemi kujdes kur bëhen krahasime, pasi numri i masave është shumë i ndryshëm në varësi të objektivit specifik. Rasti konkret, objektiv specifik 3.1 përbëhet vetëm nga 1 masë, e cila është e realizuar 100% dhe për rrjedhojë edhe objektiv specifik që e përmban atë.

Lidhur me nivelin e realizimit të masave ecurinë më të dobët, e vërejmë tek QP.3 dhe QP.6, ku një numër i lartë i masave janë mbrapa me planin e veprimit ose nuk kanë nisur ende nga zbatimi (realizueshmëria në normën 0% - 5%).

Grafiku 5: Niveli i realizimit të masave sipas objektivave për çdo qëllim politik




4.1 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit

Falë raportimeve mund të thuhet se panorama e financimit dhe planeve buxhetore ka marrë një trajtë të qartë, duke theksuar edhe nevojat reale që nevojiten në financim si dhe hendekun që duhet mbuluar nga donatorët. Kjo analizë e zbatimit të buxhetit është organizuar sipas gjashtë qëllimeve politike.

Grafiku më poshtë tregon në ngjyrë gri të errët pjesën e financimit, ndërsa në ngjyrë gri të çelët pjesën e shpenzimeve financiare të realizuara për periudhën e raportimit. Informacioni më i plotë është mbledhur për QP.1 “Promovimi dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm lokal” duke patur një panoramë të qartë të ecurisë së këtij qëllimi. Shpenzimet totale të këtij qëllimi politik rezultojnë në vlerën 2.480.652.254 ALL, ndërsa buxheti total kap vlerën 4.023.214.824 ALL.

Ndërsa për qëllimet QP.4 “Rritja e autonomisë financiare vendore” kemi buxhet total 212.218.333 ALL, QP.5 “Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i i agjendës së integritetit evropian” buxhet total 7.056.000 ALL dhe QP.6 “Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore” informacioni i grumbulluar është i cunguar si pasojë e mosraportimit. Informacion ka vetëm për buxhetin total në vlerën 294.525.000 ALL.

Grafiku 6: Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit sipas gjashtë qëllimeve politike




4.2 Niveli i përgjithshëm i riskut

Sipas kategorizimeve të sipërpërmendura në metodologji lidhur me vlerësimin e riskut, evidentojmë në grafikun 7, se cilët objektive kanë me riskun më të lartë që mund të ndikojë negativisht në realizueshmërinë e masave e për rrjedhojë të qëllimit politik.

OS. 3.2 “Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve vendore dhe integrimi në portalin e-Albania”, si dhe OS. 6.4 “Rishikimi i rolit të Institucionit të Prefektit, forcimi i monitorimit dhe rritja e bashkëpunimit me degët territoriale” janë me nivel risku zero pasi për këto dy objektiva nuk është arritur të merret informacioni i duhur për të bërë të mundur përlllogaritjen e riskut.

Ndërsa OS.4.1, OS.4.2, OS.4.3 janë objektivat me riskun më të lartë, duke sjellë që edhe QP.4 lidhur me forcimin e financave vendore të jetë qëllimi politik më i riskuar dhe ky risk të ketë impakt të lartë në zbatim dhe realizim produkti.

Grafiku 7: Niveli mesatar i riskut për çdo objektiv specifik



4.3 Analiza e progresit të indikatorëve të performancës

Progresi kundrejt objektivave do të matet duke përdorur indikatorët përkatës të performancës sipas çdo fushe prioritare.

Figura 3 jep informacion të detajuar për ecurinë e 13 indikatorëve të strategjisë duke i krahasuar vlerat e raportuara aktuale për vitin e raportimit, me vlerën e synuar në vitin përkatës. Për vitin 2023 raportohet tendenca vetëm për ato tregues që kanë të përcaktuar vlerën bazë në dokumentin e Strategjisë, ose në formatet e raportimit të shpërndara Ministrive, ku është kërkuar plotësimi i të dhënave për vitin 2022 në rastet kur mungon. Raportimi i viteve 2024 dhe 2025, do të përfshijë dhe ecurinë krahasimore të progresit me vitin pararendës. Disa tregues, siç është TP.5 “Përqindja e standardeve minimale të shërbimeve vendore të hartuara dhe miratuara” kanë rezultate nga disa institucione dhe janë të ndikuar nga një mori masash, e njëjta vlen edhe për TP.2 “Numri i bashkive që financojnë shërbimet sociale me bazë komunitare”. Ndërsa për treguesit e tjerë ndikimi është i drejtpërdrejtë nga një institucion duke e lehtësuar analizën.

Indikatorët me performancën më të lartë janë:

- a) “Numri i bashkive që financojnë shërbimet sociale me bazë komunitare”, i cili në në fund të vitit 2023 rezultoi në 45 bashki, nga të cilat 14 bashki në vitin 2022 dhe 31 bashki në 2023, duke e tejkaluar vlerën e synuar prej 19 bashkive.

- b) “Trajnimi i personelit vendor çdo vit në përputhje me vlerësimin e nevojave për trajnim”, e cila ka një tejkalueshmëri të objektivit të vendosur prej 1.000 trajnime të synuara në 3.566 trajnime të realizuara.

Treguesi tjetër me përparim pozitiv është “Raporti i të ardhurave të veta vendore në raport me PBB (%)”. Ky indikator ka patur një ecuri modeste me 0,01 pp, duke rritur vlerën aktuale 1,50% në 1,51%. Gjithashtu edhe për indikatorin “Raporti i financimit nga transfertat e pakushtëzuar dhe taksat e ndara në raport me PBB-në (%)” të raportuar nga MF, kemi një rritje me 0.02 pp duke shënuar rritje nga vlera bazë 1,50%, në 1,52% në fund të 2023. Një tjetër sukses është edhe rritja e “Numrit të planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor”. Gjatë vitit 2023 janë hartuar 3 plane të reja integriteti për bashkitë duke e çuar këtë në numër në 23 plane. Ky indikator edhe gjatë 2024 do të jetë me rritje pasi vetëm në gjysmën e parë të 2024 janë hartuar dhe miratuar 5 plane të reja Integriteti.

Indikatorin “Numri i planeve vendore për emergjencat civile të hartuara nga bashkitë”, ka patur një tendencë pozitive me 8 (tetë) bashki të cilat i kanë miratuar këto plane për vitin 2023, nga 5 që ishte objektivi i vendosur. Gjithashtu indikatorin “Numri i bashkive që trajtojnë mbetjet sipas standardeve”, ka shënuar një rritje me 2 bashki, në vitin 2022, 18 bashki dhe në vitin 2023, 20 bashki.

Indikatorin i vetëm i cili ka qëndruar i pandryshuar është “Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në raport me PBB (%) në vlerën e 0,3%. Gjithashtu ky indikator është siguruar nga raportimi i MF. Në lidhje me indikatorin e “Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%)” i cili ka shënuar një rënie të lehtë me 0,01 pp, vlera e synuar ishte ajo e 3,1% ndërkohë që ka mbetur në vlerën bazë prej 3% që ky indikator ka patur në 2022.

Indikatorin i fundit, ai i “Përqindjes së adresimit të rekomandimeve të qeverisjes vendore në Këshill Konsultativ nga Ministrinë e Linjës” shënon një ecuri pozitive me 8 pp rritje, duke tejkeluar vlerën e synuar nga 40%, në 48%. Një tregues ky i rëndësishëm i rolit të Këshillit Konsultativ si forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore.

Për dy indikatorët “Përqindja e Kilometrave të kanaleve dytësore dhe të treta të ujitjes dhe kullimit që mirëmbahen”, “Përqindja e standardeve minimale të shërbimeve vendore të hartuara dhe miratuara”, mungojnë të dhënat krahasimore.

Figura 3: Ecuria e Indikatorëve të Performancës

Institucioni raportues	Emërtimi i indikatorit	Statusi i progresit (aktuale/synim)	Vlera aktuale 2023	Vlera e synuar për vitin 2023	Vlerat bazë 2022	Vlera e progresit (aktuale-bazë)	Tendenca
AMW/MBZHR	Përqindja e kilometrave të kanaleve dytësore dhe të treta të ujitjes dhe kullimit që mirëmbahen		31%	10% më shumë	mungon për vitin 2022	mungojnë të dhënat	
MSHVS	Numri i bashkive që financojnë shërbimet sociale me bazë komunitare		74% (45 bashki)	31% (19 bashki)	23% (14 bashki)	51 pp (31 bashki)	↑↑↑
MTM	Numri i bashkive që trajtojnë mbetjet sipas standardeve		20 bashki	5 me shumë	18 bashki	2 bashki	↑↑↑
ASPA	Trajnimi i personeli tvendor çdo vit rre përputhje me vlerësimin e nevojave për trajnim		3566	1000	1000	2566	↑↑↑
MB/AMW/Mnistri të Lirjës	Përqindja e standardeve minimale të shërbimeve vendore të hartuara dhe miratuara		mungojnë të dhënat	10%	mungon për vitin 2022	mungojnë të dhënat	
MF	Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në raport me PBB (%)		0.3%	0.3%	0.3%	0 pp	
MF	Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%)		3.0%	3.1%	3.1%	-0.1 pp	↓↓↓
MF	Raporti i të ardhurave të veta vendore në raport me PBB (%)		1.51%	1.50%	1.50%	0.01 pp	↑↑↑
MF	Raporti i financimit nga transfertat e pakushtëzuar dhe taksat e ndara në raport me PBB-në (%)		1.52%	1.50%	1.50%	0.02 pp	↑↑↑
NIW/AKMC	Numri i planeve vendore për emergjencat civile të hartuara nga bashki të		28 bashki	5 më shumë	20 bashki	8 bashki	↑↑↑
AMW	Numri i planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor		23 bashki	5 më shumë	20	3 bashki	↑↑↑
AMW	Numri i akteve ligjore që përfaqësojnë direktivat e BE-së të shqyrtuara nga KK		16.95%	30.00%	20.00%	-3.1 pp	↓↓↓
AMW	Përqindja e adresimit të rekomandimeve të qeverisjes vendore në Këshill Konsultativ nga Ministri të Lirjës		48%	40%	30%	8 pp	↑↑↑

5. Analiza e progresit drejt qëllimeve politike (6 shtyllave të strategjisë)

Në vijim jepet një analizë e detajuar e objektivave dhe masave kryesore për të cilat ka patur progres plani i zbatimit sipas çdo qëllimi politik.

Në shtojcën nr. 1 jepet informacioni në narrativ specifikisht për çdo masë të objektivave specifik.


5.1 QP1: Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Statusi i zbatimit të qëllimit të parë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në **masën 51%**. Në figurën 3 paraqiten katër objektivat specifik për QP.1, me masat përkatëse të detajuara në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Nga pikëpamja e përgjithshme kemi një realizim objektivash shumë të mirë lidhur me realizimin e produkteve për masë.


Figura 4: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifikë në QP1

Objektivi Specifik	1.1	1.2	1.3	1.4
E pa gjurmuar	0			
Pa filluar	3			
Me vonesë		4	2	3
Në kohë	2	4	5	
Përfunduar	1	1	2	1
Gabim				
Realizimi në përqindje (%)	43%	53%	65%	43%
Statusi i Objektivit	Mirë	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë

Grafiku 8: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP1



Grafiku 9: Zbatueshmëria e masave të QP1



Në grafikun 9, paraqitet grafikisht niveli i zbatimit të çdo mase në nivel objektiv specifik. Konkretisht në OS.1.1 kemi 3 masa të cilat nuk kanë nisur procesin e zbatimit, ndërsa vetëm 2 masa janë në proces realizimi me ecuri sistematikisht të mirë, si dhe 1 masë të realizuar plotësisht. Kjo masë është në përgjegjësinë kryesore të NJVV-ve e lidhur me përfundimin e procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, rishikimit të planeve të miratuara dhe hartimit të planeve strategjike zhvillimore.

Për masën 1.1.1 “Përfundimi i procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, rishikimi i planeve të miratuara dhe hartimi i planeve strategjike zhvillimore”, 56 NJVV kanë raportuar që kanë plane të përgjithshme vendore, ndërsa bashkitë e tjera janë në proces miratimi. Për sa i përket planeve strategjike zhvillimore nga Këshilli Bashkiak, 20 bashki i kanë miratuar nga KB ndërsa pjesa tjetër e bashkive nuk i kanë të miratuara.

Masa 1.1.2 “Rijetësimi dhe prezantimi i incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërvendore dhe me aktorë të tjerë joqeveritarë”, nëpërmjet rajonalizimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, është arritur të realizohet me sukses ky ushtrim.

Masa 1.1.3 “Rishikim i kuadrit ligjor mbi skemat vendore/praktikave ekzistuese të mbështetjes dhe bashkëpunimit me biznese”, ende nuk është arritur të realizohet.

Masa 1.1.4 “Qartësimi i hapësirave/mbivendosjeve ligjore lidhur me rijetëzimin e shoqërive tregtare”, masa ende nuk është realizuar.

Edhe masa 1.1.5 “Hartimi i një udhërrëfyesi për bashkitë mbi mbështetjen e bizneseve vendore me grante apo shërbime të tjera” ende nuk është realizuar.

Në lidhje me masën 1.1.6 “Identifikimi i vazhdueshëm i praktikave të mira të lidhura me bashkëpunimin bashki-biznes dhe inkurajimi e orientimi i bashkive për replikim apo përshtatje sipas rastit”, vëmë re një përmirësim të klimës së biznesit në disa bashki. Janë aplikuar politika fiskale të favorshme, sidomos për bizneset start-up dhe për bizneset në fushën e agro-turizmit.

Progres për t’u veçuar është realizuar për objektivin specifik 1.3 në lidhje me forcimin e zhvillimit bujqësor dhe rural. Institucionet përgjegjëse për këtë masë janë NJVV-të të cilat kanë raportuar informacione të detajuara rreth ecurive të arritura. Ndërsa për sa i përket raportimit nga MF për vitin 2023 në këtë objektiv rezulton se pushteti vendor ka realizuar shpenzime kapitale nga fondet e veta në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” në masën 353,8 milion lekë.

Masa 1.2.1 lidhet me “Shfrytëzimin e aseteve vendore, si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim i gjenerimit të të ardhurave. Identifikim, vlerësim dhe klasifikim të pronave të bashkive (inventarizim nga secila bashki)”, ku 42 bashki e kanë kryer një inventarizim të aseteve, ndërsa bashkitë e tjera kanë raportuar se nuk kanë inventar.

Masa 1.2.2 “Strategji/Plan të vënies në përdorim të aseteve vendore nga ana e bashkive (përcaktimin e burimeve financiare dhe politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë/planit) është e lidhur me masën e mëparshme ku nga këto bashki të cilat kanë një inventar të aseteve të ndodhura në territorin e bashkisë, 5 (pesë) bashki (Vau i Dejës, Kuçovë, Dimal, Konispol dhe Bulqizë) kanë plane për vënien në përdorim të aseteve për gjenerimin e të ardhurave.

Masa 1.2.3 “Bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV me qëllim rritjen e ekonomisë vendore”. Ky është një proces i vazhdueshëm bashkëpunimi midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror, nëpërmjet vendimeve të këshillit të ministrave, për transferimin e pronave publike tek NJVV, për realizimin e projekteve dhe investimeve të ndryshme. Realizimi i kësaj mase është lehtësisht i verifikueshëm, pasi evidentohet një rritje e volumit të transferimit të pronave nga qeverisja qendrore te pushteti vendor.

Për masën 1.2.4 “Vlerësimi i mundësisë së lehtësimit të formave të pagesës për regjistrimin e titujve të pronësisë në favor të NJVV-ve dhe një kuadër ligjor të unifikuar dhe të kombinuar me përgjegjësi të qarta të gjithë aktorëve”, informacioni është siguruar nga raportimi i ASHK, ku konstatohet se, projektvendimet për reduktimin e tarifave për NJVV-të “Për një ndryshim në vendimin nr.389 datë 13.5.2020” dhe “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, janë dërguar në Këshillin e Ministrave për miratim.

Për masën 1.2.5 “Rijetëzimi i aseteve natyrore (Si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore)”, bashkitë kanë raportuar se 20 prej tyre kanë plane të mbarështimit të pyjeve, ndërsa bashkitë e tjera nuk kanë realizuar ende një të tillë, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore të kualifikuara si dhe për shkak të kostos së lartë për përgatitjen e një plani. Praktika e deritanishme tregon se bashkitë me burime financiare të ulëta, hasin vështirësi për planifikimin e fondeve që duhen për përgatitjen e planeve të mbarështimit. Në lidhje me fondin e tokave bujqësore, një pjesë e mirë e këtyre pasurive janë ende në administrimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke e zbehur rolin e bashkive për rijetëzimin e tyre.

Masa 1.2.6 “Kordinimi ndërbashkiak në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarështimit të pyjeve me qëllim zhvillimin ekonomik vendor” bashkitë që bëjnë pjesë në planin e mbarështimit me koordinimin ndërmjet tyre janë: Vau i Dejës, Fier, Vlorë, Devoll, Gramsh, Korçë, Pogradec, Pustec, Skrapar, Shkodër, Tiranë, Përmet, Fushë-Arrëz, Dropull, Berat, Mallakastër, Elbasan, Sarandë, Përrenjas, Librazhd, Mirditë dhe Gjirokastrë.

Masa 1.2.7 “Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e kapitalit natyror”, është realizuar me sukses. Përgjatë vitit 2022, AMVV në bashkëpunim me OSCE ka hartuar dhe miratuar metodologjinë për vlerësimin e kapitalit natyror.

Masa 1.2.8 “Vlerësimi i kapitalit natyror për secilën bashki sipas metodologjisë së miratuar”, përgjatë vitit 2023, janë kryer në 37 bashki trajnimet për vlerësimin e kapitalit natyror. Në vitin 2024 janë zhvilluar trajnimet për 21 bashki të tjera. Në vitin 2023 masa është realizuar për 13 bashki.

Masa 1.2.9 “Hartimi i planit të menaxhimit të kapitalit natyror për secilën bashki”, nga raportimet e bashkive, konstatohet se janë 13 bashki të cilat e kanë hartuar planin në vitin 2023.

Progres për t’u veçuar është realizuar për objektivin specifik 1.3 në lidhje me forcimin e zhvillimit bujqësor dhe rural. Institucionet përgjegjëse për këtë masë janë NJVV-të të cilat kanë raportuar informacione të detajuara rreth ecurive të arritura.

Masa 1.3.1 “Nxitja e rolit të bashkisë për mbështetje nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR-së”, nga të dhënat, rezulton se nga skema kombëtare e bujqësisë dhe zhvillimit rural, bashkitë kanë marrë një rol të rëndësishëm në

lehtësimin e proceseve të aplikimit nga fermerët për subvencionimin për naftën dhe procesin e matrikullimit të gjedhëve.

Masa 1.3.3 “Nxitja e rolit të bashkive dhe konsolidimi i kapaciteteve të tyre në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, duke e mbështetur edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore, si dhe fuqizimin e bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën administrimin e MBZHR-së, atyre dytësore dhe tretësore nën kompetencën bashkiake” ka një raportim në process lidhur me statusin e masës. MBZHR është shprehur se për periudhën 2024-2026 një fond prej prej 1,200,000,000 lekë është parashikuar për rehabilitimin e objekteve të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Për aktet nënligjore, ky produkt është realizuar në vitin 2019.

Masa 1.3.4 “Organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sigurinë e digave dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja në pronësi të NJVV-ve” ka një raportim nga ku theksohet se bashkia Pogradec ka numrin e digave me rrezikshmëri më të lartë prej 15 digash, ndërsa bashkitë Maliq, Mat, Kolonjë kanë nga 5 (pesë) diga me rrezikshmëri. Pas tyre vijnë bashkitë Tropojë, Dropull dhe Shijak me 4 diga të raportuara.

Në lidhje me masën 1.3.5 për sa i përket kryerjes së studimit të parafizibilitetit të rreth 430 digave dhe përdorimit të tyre për ujitje, mbështetur në studimet e mëparshme të sigurisë së tyre, MBZHR ka raportuar se ka përgatitur termat e referencës për këtë studim të cilat i janë përcjellë Bankës Botërore. Janë në fazë diskutimi modalitetet e implementimit të këtij projekti me partner kryesor AMBU.

Masa 1.3.7 “Ofrimi i shërbimit të qendrueshëm të ujitjes në sipërfaqe potencialisht të ujitshme 360.000 ha (Vazhdimi i ujitjes së qendrueshme në rreth 250.000 ha me infrastrukturë ujitëse të rehabilituar, plotësisht/pjesërisht dhe shtimi i aftësisë ujitëse me rreth 110.000 ha, kryesisht në skemat ujitëse me ngritje mekanike me stacionet pompimi)”, nga raportimet e NJVV në matjen e performancës, konstatohet se kemi një përmirësim të aftësisë ujitëse dhe të dhënat tregojnë rritje të sipërfaqes bujqësore të ujitur me rreth 60.000 ha.

Në lidhje me masën 1.3.8 “Ofrimi i shërbimit të qendrueshëm të kullimit në sipërfaqe potencialisht të kullueshme në 280.000 ha (Vazhdimi i procesit ciklik vjetor të pastrimit të rrjetit të kanaleve kulluese të parët nga MBZHR dhe të dytë, e të tretë nga NJVV, si dhe përmirësimi teknik i hidrovoreve)”, nga raporti i performancës së bashkive kemi një rritje prej 57 % të ofrimit të shërbimit të kullimit, duke arritur vlerën rreth 150.000 ha sipërfaqe e kullueshme.

Ndërsa për sa i përket raportimit nga MF për vitin 2023 në masën 1.3.9 “Përmirësimi i sigurisë së mbrojtjes nga përmytja”, rezulton se pushteti vendor ka realizuar shpenzime kapitale nga fondet e veta në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” në masën 353,8 milion lekë. Sipas MF ka patur një projekt investimi për bashkinë Klos nga MBZHR të realizuar në vlerën 2.2 milion lekë.

Masa 1.3.10 “Performanca e ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit nga NJVV, nëpërmjet popullimit me të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Ujitjes dhe të Kullimit nga vetë NJVV (ujitja.al) dhe vlerësimi i performancës”. Nga raportimi i NJVV, vërehet progresi i bërë në lidhje me performancën e ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit. Në

analizimin e të dhënave për matjen e performancës së bashkive, në krahasim me vitin 2022, vihet re rritje e treguesve dhe parametrave në ofrimin e këtij shërbimi.

Në lidhje me masën 1.3.11 “Qartësimi i kompetencave për sanksione administrative direkte për bashkitë në lidhje me shkeljet në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve e kullotave”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar udhëzimin nr.17, datë 20.4.2023 “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve”.

Masa 1.4.1 “Fuqizimi i strukturave të turizmit vendor në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor” nga raportimi i NJVV, konstatohet një vëmendje e shtuar në lidhje me konsolidimin e strukturave të turizmit. Veçanërisht në bashkitë bregdetare dhe në bashkitë me volum të lartë të numrit të turistëve, janë krijuar pikat e informacionit dhe funksionojnë guidat turistike të ofruara nga operatorë të licencuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Në lidhje me masën 1.4.2 “Rishikimi i kuadrit ligjor mbi Trashëgiminë Kulturore”, Nga raportimi i Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit është raportuar se gjatë vitit 2023 janë miratuar vendimet e këshillit të ministrave nr. 730, datë 13.12.2023 “Për miratimin e zonifikimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të **Sarandës** dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, Vendim KM nr.637, date 15.11.2023 “Për miratimin e zonës arkeologjike “A” të Gradishtës së **Selcës** dhe planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”, Vendim KM nr. 764, datë 20.12.2023 “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin e **Gjirokastrës**, percaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”, Vendim nr. 827, date 28.12.2023 “Për deklarimin e Qendrës Historike të një zone në qytetin-muze të **Beratit**, percaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj” dhe Vendim KM nr. 831, date 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të **Durrësit** 2021-2028

Masa 1.4.3 “Ngritja e një sistemi/databaze të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor”. Nëpërmjet aplikacionit TEA, është bërë e mundur aplikimi i ngritjes së sistemit. Të dhënat në lidhje me zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë ende në plotësim.

Masa 1.4.4 “Aplikimi i instrumentave innovative si zonat e përmirësimit të biznesit dhe turizmit”, rezulton se në disa bashki, atraksione turistike janë krijuar zonat BID dhe TID, në përmbushje të kësaj mase.


5.2 QP2: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët

Statusi i zbatimit të qëllimit të dytë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në **masën 53%**. Në figurën 5 paraqiten katër objektivat specifik për QP.2, me masat përkatëse të detajuara në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Realizimi mund të cilësohet shumë i mirë në nxjerrje të produkteve të këtij qëllimi.


Figura 5: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP2

Objektivi Specifik	2.1	2.2	2.3	2.4
E pa gjurmuar				
Pa filluar	1	1	3	
Me vonesë	1	18	4	1
Në kohë		15	2	1
Përfunduar	2	16		1
Gabim				0
Realizimi në përqindje (%)	56%	58%	23%	73%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Shumë mirë	Mirë	Shumë mirë

Grafiku 10: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP2



Grafiku 11: Zbatueshmëria e masave të QP2



Masa 2.1.1 “Vlerësim/studim mbi efikasitetin e ofrimit të shërbimeve të ushtruara nga bashkitë”. Në fundin e vitit 2023 dhe fillimin e vitit 2024 është zbatuar në 15 bashki programi i analizës së funksioneve nga AMVV, në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta.

Masa 2.1.2 “Studim/analizë e përditësuar e harmonizimit ligjor, duke përfshirë mbivendosjet dhe hapësirat potenciale midis ligjit organik dhe ligjeve sektoriale”, është hartuar raporti i analizës së funksioneve nga AMVV, për 15 bashki.

Masa 2.1.3 “Harmonizimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që përcaktojnë marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për forcimin e rolit të NJVV në zbatimin e funksioneve”. Me amendimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për Këshillin Konsultativ, procesi i harmonizimit është në vijimësi.

Për masën 2.1.4 “Përgatitja e manualeve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit (të përzgjedhura) që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV për një ofrim sipas standardeve të shërbimeve”. Me përjashtim të shërbimeve të policisë bashkiake dhe menaxhimit të mbetjeve, të cilat kanë rregullore të funksionimit, masa nuk është realizuar për shërbimet e tjera.

Për masën 2.2.1 “Harmonizimi ligjor për kompetencat e NJVV-ve për shërbimet e UKN”, në bazë të VKM 302, datë 11.05.2022 sipas AMBU është kryer riorganizimi i shërbimeve të UKN nëpërmjet rajonalizimit të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve.

Për masën 2.2.2 “Hartimi i planeve 5-vjeçare të biznesit për të gjitha ndërmarrjet rajonale UKN sh. a në konsultim me NJVV-të”, shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizimeve të krijuara janë të pajisura me planet e biznesit.

Masa 2.2.3 “Asistencë teknike për NJVV-të për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur, në kuadër të reformës së rajonalizimit të UKN sh. a”. Shoqëritë e reja rajonale të krijuara kanë aplikuar ose janë në proces aplikimi pranë ERRU për ndryshimin e tarifave, si institucion kompetent për përcaktimin dhe ndryshimin e tarifave të shërbimit. Nga konstatimet, 20% e bashkive kanë miratuar në ERRU ndryshimin e tarifave të shërbimit, për vitin 2023.

Lidhur me masën 2.2.4 “Hartimi i kuadrit rregullator për përcaktimin e kriterëve dhe rregullimin e mbrojtjes së burimeve ujore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm”, AMBU gjatë vitit 2023 ka prodhuar një dokument analitik për nevojën e ndryshimeve ligjore, dhe në muajin prill të vitit 2024 është miratuar ligji për mbrojtjen e burimeve ujore.

Masa 2.2.5 “Rishikimi i kuadrit rregullator për arsimin, me qëllim përfshirjen e vetëqeverisjes vendore në të gjitha proceset e arsimit parashkollor, përmes një procesi gjithëpërfshirës”, nga MAS raportohet se është zhvilluar analiza e kuadrit rregullator dhe po punohet për hartimin e një pakete ligjore në tërësi për arsimin parauniversitar.

Në lidhje me masën 2.2.6 “Avancimi i decentralizimit të funksionit të arsimit parashkollor duke i dhënë kompetencën bashkive a. hartimi i politikave nga qeverisja vendore, b. të përshtatin funksionin me rrethanat vendore dhe c. të përfshijë aktorët lokalë (si këshillat e prindërve” në procesin e vendimmarrjes”, përgjatë vitit 2023 është draftuar urdhri i Kryeministrit për mekanizmin pilot “decentralizimi horizontal”, i cili është miratuar në vitin 2024.

2.2.7 Krijimi i “Konferencës Ndërbashkiake për Arsimin Parashkollor” si organ vendor ose rajonal për të koordinuar bashkitë, (ose si një grup pune i Shoqatave të Bashkive) me qëllim diskutimin e problemeve dhe projekteve të përbashkëta”, nga raportimi që bashkitë kanë dërguar, vetëm 10 prej tyre kanë raportuar se e kanë krijuar konferencën ndërbashkiake për arsimin parashkollor bashkë me informacionin për aktivitetet e ndërmarra nga bashkitë.

Masa 2.2.8 “Përcaktimi i skemës së kompensimit financiar dhe mbulimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit që ndjekin procesin mësimor në institucionet e arsimit parashkollor publike, jashtë vendbanimit”

Nga Ministria e Arsimit është raportuar se skema e kompensimit financiar është rregulluar me VKM-në nr. 682, datë 29.07.2015 “Për transportin e nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km nga vendi i banimit për në kopshtet dhe çerdhe.

Masa 2.2.9 “Rritja e rolit të pjesëmarrjes së prindërve në edukimin parashkollor përmes fuqizimit të bordeve dhe fushatave të dedikuara informuese”.

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është raportuar se kjo masë është realizuar me Urdhrin e Mas nr. 31/2020 “Për miratimin e rregullores së institucioneve arsimore parauniversitare”.

Masa 2.2.10 “Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për menaxhimin e shërbimit të arsimit parashkollor përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar”

Nga ana e Ministrisë së Arsimit është raportuar se masa është në proces realizimi dhe po punohet për ngritjen e grupit të punës nga ana e “ASCAP”.

Masa 2.2.11 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë mbledhjen e të dhënave (procedurat standarde të veprimit në arsimin parashkollor, vlerësimi i performancës së drejtorëve të kopshtit, planet e përmimirësimit të shërbimit, etj.)”

Nga Ministria e Arsimit është raportuar se brenda vitit 2024 do të ngrihet grupi i punës për hartimin e udhëzuesit për vlerësimin e performancës së drejtorëve të kopshtit. Gjithashtu brenda vitit 2024, fillon trajnimi i drejtuesëve të kopshtit nga shkolla e drejtorëve.

Masa 2.2.13 “Rishikim i bazës ligjore për lejet e mjedisit për të përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat bashkiake rregullatore dhe monitoruese për aktivitetet industriale që kanë një ndikim relativisht të ulët në mjedis dhe që zhvillohen në zona urbane, jashtë zonave industriale”

Masa 2.2.14 “Rishikimi i kompetencës bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe kompetencës vendore në fushën e mbrojtjes nga ndotja e ajrit, ujit dhe akustike”

Masa 2.2.15 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për planet vendore të veprimit për mjedisin dhe të cilësisë së ajrit, si dhe strukturat përkatëse”

Masat e sipërcituara janë të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat janë raportuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Bashkitë për vitin 2023 nuk kanë përgatitur plane lokale për cilësinë e ajrit. Në kuadër të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit MTM ndërmori iniciativën dhe ndërhyri për ndryshimin e Ligjit ekzistues nr.162, datë 4.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, me qëllim forcimin e masave administrative në rast kundërvajtjesh (rritje me 30 gjoba në rast shkeljesh. %). Kjo nismë rezultoi pas konsultimeve kombëtare me të gjithë aktorët, të cilët ranë dakord që rritja e mëtejshme e masave administrative, me ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik, do të ndikojë në rritjen e përgjegjësisë së veprimtarive industriale për të qenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe për të parandaluar ndotjen e mjedisit, me qëllim kryesor mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Projektvendimi “Për propozimin e Projektligjit “Për disa ndryshime në Ligjin nr.162, datë 4.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar”, është miratuar me VKM nr. 259, datë 02.05.2024 për të vijuar procedurat e mëtejshme.

Masa 2.2.16 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi”, në lidhje me këtë proces, MTM ka kryer propozimet për ndryshimin ligjor për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit në 2023, ndryshime të cilat janë miratuar në vitin 2024.

Masa 2.2.17 “Vlerësim strategjik të mjedisit të secilës bashki (identifikim i problemeve mjedisore, përditësim i zonave të ndjeshme ku ndodhen ndërtesat me kërkesa të veçanta për nivelin e zhurmave, përcaktim i objektivave vendore të mjedisit për secilën bashki, etj.) Në përbërje të planeve të përgjithshme vendore, janë të integruara dhe vlerësimet strategjike të mjedisit për bashkitë.

Masa 2.2.18 “Nisma për edukimin ambiental të komunitetit (rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, hedhjen e tyre me orar si edhe përdorimi i çantave ekologjike të riciklueshme, të cilat përmirësojnë dhe mbrojnë mjedisin urban)”.

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe NJVV, janë realizuar nisma për edukimin ambiental të komunitetit në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2023, kryesisht për përdorimin e qeseve dhe çantave të riciklueshme. Gjithashtu theksojmë praktikën që ndiqet nga Bashkia Lezhë për menaxhimin e mbetjeve.

Masa 2.2.19” Studimi për përcaktimin e zonave të mbetjeve dhe modelit institucional të qeverisjes dhe organizimit të Zonave të Mbetjeve dhe rolin e NJVV-ve”

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është raportuar se në datë 27.05.2020 është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 418, “Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Menaxhimi i mbetjeve në nivel vendor administrohet nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duke përdorur forma të ndryshme menaxhimi, bazuar dhe në masterplanin e miratuar nga KKT për secilën bashki.

Masa 2.2.20 “Studim dhe asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve përfshirë dhe rishikimin e kuadrit rregullator”

Nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është raportuar se në kuadër të menaxhimit të qendrueshëm të mbetjeve, Ministria ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin e ligjit nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” me qëllim forcimin e masave administrative në rast kundërvajtjesh. Gjithashtu me vendimin nr. 132, datë 06.03.2024 është miratuar mënyra e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve. Në lidhje me qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV me qeverinë qendrore nuk ka asnjë zhvillim.

Masa 2.2.21 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë edhe mbledhjen e diferencuar dhe riciklimin (planet e menaxhimit të mbetjeve, paketa fiskale, etj.)”

Bashkitë në bashkëpunim me pushtetin qendror përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe parimet e “vetë-mjaftueshmërisë”

Masa 2.2.22 “Hartimi i kuadrit rregullator për zbatueshmërinë e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për bashkitë dhe qarqet”

Nga Ministria e Mjedisit është raportuar se kjo masë është në proces zbatimi dhe po punohet për hartimin e ligjit të PZP, ku është përgatitur drafti i parë i cili është publikuar në faqen zyrtare të MTM-së dhe është në konsultim publik.

Masa 2.2.23” Konceptimi dhe hartimi i masave nxitëse fiskale dhe financiare për aktivitetet ricikluese dhe kompostuese në nivel vendor”.

Nga ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar se me mbështetjen financiare nga projekti “GIZ”, po financon ndërtimin e qendrave të kompostimit në 10 bashki të vendit. Gjithashtu

bashkëpunimi vazhdon dhe me AFD dhe Bankën Botërore për zbatimin e projektit të EU4CE dhe Green Groeth. Ky projekt përfshin menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake duke implementuar konceptin e ripëdorimit, riciklimit dhe reduktimit (3R) si dhe mbylljen e landfilleve të cilat nuk plotësojnë kushtet sanitare, përkatësisht për rajonin e Kukësit dhe Gjirokastrës.

Masa 2.2.24 “Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për mobilizimin e komunitetit për ndarjen në burim dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit”.

Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është raportuar se në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve në tetor të vitit 2023 ka filluar implementimin e programit për edukimin mjedisor (3R programme) në 37 Shkolla të Bashkisë Tiranë.

Masa 2.2.25 “Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial për menaxhimin e shërbimit të mbetjeve përmes një kurrikule dhe sistemi çertifikimi të njehsuar”.

Stafi teknik në nivel qendror dhe vendor trajnohen në mënyrë të vazhdueshme duke u përfshirë edhe në projekte të cilat kanë si qëllim menaxhimin e integruar të mbetjeve. Punonjësit e NJVV, përgjatë vitit 2023 janë trajnuar nga ekspertë të huaj të kontraktuar nga donatorët e huaj për menaxhimin e shërbimit të mbetjeve.

Masa 2.2.26 lidhur me “Hartimin e raportit të vlerësimit për mbikëqyrjen e sigurisë së digave dhe rolin e NJVV-ve”, sipas raportimit të MBZHR është një proces në përgjegjësi direkte të bashkive bazuar në ligjin nr.8681, datë 02.11.2000, proces i cili varet nga gjendja e digës e kontrolluar 1 herë në vit, raporti për sigurinë e të cilave i dërgohet KKDM-së.

Masa 2.2.27 Harmonizimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve ujore vendore”.

Nga Agjencia për Mbrojtjen e Burimeve Ujore është punuar gjatë vitit 2023 për harmonizimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve ujore vendore”. Në prill të vitit 2024 është miratuar ligji nr. 29/2024 datë 4.4.2024 “Për Burimet Ujore”.

Masa 2.2.28 “Harmonizimi i kuadrit rregullator për transportet rrugore. Përafrimi i kuadrit ligjor me acquis të BE-së, lidhur me shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”. MIE ka raportuar se përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me acquis të BE-së, është në proces. Në korrik 2023, përgjatë procesit të Screening, MIE ka raportuar pranë Komisionit Evropian, për nivelet e përafrimit duke prekur edhe shërbimet publike të këtij lloji transporti, (transportin urban plus interurban plus ndërkombëtar).

Masa 2.2.29 “Hartimi dhe miratimi i projekteve për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve të udhëtarëve dhe autobusëve të shërbimit të transportit publik vendor” ka gjetur zbatim vetëm në 13 (trembëdhjetë) bashki (Poliçan, Tiranë, Fushë-Arrëz, Dibër, Berat, Kuçovë, Sarandë, Pogradec, Lushnjë, Pukë, Mirditë, Durrës dhe Fier) të cilat kanë projekte për ndërtimin e terminaleve të udhëtarëve dhe autobusëve.

Për masën 2.2.32 “Studimi për mekanizmin e Fondit Social dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel bashkie ose qarku si edhe gjithë aktorëve në përdorimin efektiv të Fondit Social”, MSHMS raporton se është realizuar studimi mbi mekanizmin e Fondit Social, si analiza e kuadrit rregullator të funksionimit, ashtu dhe të zbatimit në praktikë. Bazuar në

rekomandimet dhe sfidat e identifikuarra, është rishikuar VKM 150/2028 "Mbi metodologjinë e përllogaritjes së Fondit Social", që u finalizua me miratimin e VKM 224/2024.

MSHMS raporton se për masën 2.2.33 "Plotësimi i kuadrit rregullator për prokurimin e shërbimeve sociale (manual dhe udhëzues) dhe bashkëpunimin me aktorë publikë e private", është hartuar udhëzuesi për zbatimin e procedurave të prokurimit publik për shërbimet sociale, ku janë trajnuar të gjitha stafet përgjegjëse për prokurimin në 61 bashki.

Masa 2.2.34 "Mbështetja për fuqizimin e NJVNR-ve për menaxhimin e rasteve në mënyrë graduale në të gjitha njësitë vendore". MSHMS gjatë vitit 2023 ka realizuar trajnime online për të gjitha stafet e shërbimeve sociale në 61 bashki lidhur me menaxhimin e rasteve nëpërmjet Regjistrin elektronik të shërbimeve sociale. Ndërkohë bashkitë asistohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Shërbimit Social Shtetëror.

Masa 2.2.35 "Rritje kapacitetesh për stafet vendore për menaxhimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve, përfshirë nënkontraktimin e kujdesit social bazuar në modele, sigurimin e cilësisë dhe inspektimin". Nga raportimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezulton se janë realizuar trajnimet në 5 (pesë) Qarqe të vendit lidhur me procedurat e prokurimit të shërbimeve me stafet lokale përgjegjëse për këto procedura. Trajnimet janë realizuar pasi është hartuar udhëzuesi i procedurave të prokurimit të shërbimeve sociale, bazuar në vkm-në 768/2021 "Për prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike".

Masa 2.2.36 "Identifikimi dhe planifikimi i shërbimeve të nevojshme në nivel bashkie e qarku për gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe PAK (shërbime të specializuara)" MSHMS raporton se 61 bashkitë kanë hartuar Planet Sociale, ku 45% e tyre janë në proces rishikimi, për shkak të përfundimit të afateve të planit 3 vjeçar të mëparshëm, ndërsa për shkrimin e planeve sociale rajonale, ky proces nuk ka nisur ende.

Masa 2.2.37 "Ngritja e shërbimeve të specializuara në mbështetje të reformës PAK dhe përmirësimi i aksesit fizik në këto shërbime, shoqëruar me paketën për referim dhe ofrim të rehabilitimit, si edhe riaftësimin e tyre" është mbledhur informacion lidhur me realizueshmërinë nga MSHMS dhe NJVV-të. Harta e shërbimeve shoqërore sipas MSHMS po zgjerohet çdo vit, ku për vitin 2023 me fond social u mbështetën 6 shërbime të reja, ndërkohë për vitin 2024, 13 shërbime të reja u mundësuan për personat me aftësi të kufizuar. Lidhur me raportimet e bashkive vetëm 36 (tridhjetë e gjashtë) prej tyre ofrojnë shërbime të specializuara PAK.

Masa 2.2.38 "Mbështetje dhe bashkëpunim proaktiv me SHSSH, AKPA për aktivizimin e përfituesve të NE-së në moshë pune dhe referimin në shërbime sociale" është raportuar nga MSHMS se bashkëpunimi do të jetë në vazhdimësi bazuar në marrëveshjen e firmosur ndërmjet institucioneve të sipërpërmendura. Për vitin 2023 janë punësuar dhe kane ndjekur kurset e trajnimit profesional 700 (shtatëqind) përfitues të ndihmës ekonomike.

Masa 2.2.39 "Ngritje e kapaciteteve për stafet vendore për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe protokollet përkatëse, koordinim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve". Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e Drejtësisë se janë zhvilluar 40 takime me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve (PMF) për ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve të të miturve në kontakt/konflikt me ligjin.

Masa 2.2.40 “Ngritja dhe përdorimi i sistemit të mbledhjes sistematike të të dhënave në lidhje me strehimin social në disa bashki pilot”, nga MSHMS nuk është dhënë informacion i plotë.

Masa 2.2.41 “Hartimi i planeve të strehimit social dhe monitorimi periodik i zbatimit të tyre”. Plan të strehimit nga KB kanë vetëm 32 bashki.

Masa 2.2.41.1 “Rritja e mbulimit të programeve të strehimit social”, nga raportimet e NJVV, në 12 bashki është rritur mbulimi me programet e strehimit social.

Masa 2.2.42 “Hartimi i metodologjisë të ndërhyrjes dhe procedurave standarde për ndërhyrje në rast zjarri dhe fatkeqësi natyrore”.

DPMZSH është në proces të hartimit të draftit të ligjit 152/2015 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin". Në varësi të ndryshimeve ligjore do të hartohet dhe projekt-udhëzimit i Ministrit të Brendshëm "Mbi procedurat standarde operacionale në rastet e zjarreve dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

Masa 2.2.42.1 “Identifikimi dhe hartëzimi i proceseve në të gjitha nivelet e strukturave të MZSH-së me qëllim propozimin e sistemeve inovative për lehtësimin e proceseve të punës, monitorimin në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve online për qytetarët”.

Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e Brendshme se në kuadër të përmirësimit të nivelit të performancës së shërbimit të MZSH-së, si dhe të përcaktimit të objektivave për zbatimin e politikave të veprimtarisë së shërbimit lidhur me parandalimin, inspektimin dhe ndërhyrjen, DPMZSH ka ngritur një grup për hartëzimin dhe identifikimin e proceseve në të gjitha nivelet e strukturave të MZSH-së, me qëllim propozimin e sistemeve inovative për lehtësimin e proceseve të punës. Grupi i punës ka realizuar trajnimet përkatëse në 12 bashkitë qendër qarku, lidhur me digjitalizimin. Referuar lidhjes nr. 15 të VKM nr.520, datë 25.07.2019, si një hallkë të hartëzimit të sistemit të trajnimit të raportit të ndërhyrjes.

Masa 2.2.43 “Identifikimi i projekteve që do të mundësonin digjitalizimin e shërbimit të MZSH-së lidhur me thirrjet e adresuara të numri unik 128”.

Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e Brendshme se lidhur me raportin mbi fushat /projektet prioritare për digjitalizimin e shërbimit të MZSH-së, Ministria e Brendshme (DPMZSH) ende nuk ka hartuar këtë raport, duke qene se në vitin 2023 nuk ishte i përfunduar drafti për ndryshime të ligjit 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe hartëzimit të proceseve të të gjitha nivelet e strukturave të MZSH.

Masa 2.2.44 “Hartimi i dokumenteve të strategjisë për zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor (plani kombëtar i emergjencave civile dhe plan operacional)”, nga raportimi i bërë nga AKMC, rezultojnë se 10 bashki kanë miratuar dokumentin e strategjisë për zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor, për vitin 2023.

Masa 2.2.45 “Hartimi i planit vendor për emergjencat civile” është marrë informacion bazuar nga raportimi i NJVV-ve ku 32 bashki kanë plane vendore për emergjencat civile.

Masa 2.2.46 “Krijimi i bazës së të dhënave në nivel vendor për emergjencat civile” është e lidhur me masën 2.2.45 ku nga 61 bashkitë që kanë raportuar, 44 prej tyre kanë krijuar një bazë të dhënash lidhur me emergjencat civile.

Masa 2.2.47 “Forcimi i strukturës vendore për mbrojtjen civile. Përqindja e rritjes së punonjësve në mbrojtjen civile krahasuar me 1 vit më parë” siguron informacion lidhur me rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen civile. Nga raportimi i NJVV-ve rezulton se Patosi në vitin 2023 e ka ngritur si strukturë me 3 punonjës, 1 përgjegjës e 2 specialist duke patur një realizueshmëri prej 100%, i ndjekur nga bashkia e Lushnjes me 66% rritje kapacitetesh.

2.2.48 “Trajnimi i punonjësve të NJVV dhe grupeve vullnetare komunitare për përballimin e situatave të fatkeqësive natyrore”.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar trajnime në Bashkinë Vlorë dhe Selenicë, ku janë trajnuar 46 persona nga grupet vullnetare dhe nga punonjësit e NJVV-ve.

Për masën 2.2.49 “Hartimi i akteve nënligjore në plotësim të ligjit të ri të Policisë Bashkiake” nga MB janë miratuar VKM gjatë viti 2023 për miratimin e rregullores, uniformën e shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të policisë bashkiake.

Masa 2.2.50 “Plotësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike”. Në lidhje me këtë masë Ministria e Brendshme ka raportuar se është parashikuar hartimi dhe miratimi i projektvendimit të këshillit të ministrave për katërmujorin e dytë të vitit 2024.

2.2.51 “Nxitja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i punonjësve të policisë bashkiake”. Përgjatë vitit 2023, Akademia e Sigurisë ka zhvilluar disa sesione trajnimesh për kundërvajtjet administrative me strukturat e policisë bashkiake.

2.3.1 “Hartëzim i të gjithë standardeve të shërbimeve të ofruara nga bashkitë, duke i ndarë sipas llojit të standardeve (teknike, administrative, shërbimi)” kjo masë ende nuk është realizuar.

Masa 2.3.2 “Hartimi i metodologjisë për vendosjen e standardeve kombëtare minimale për shërbime të përzgjedhura” është miratuar Korniza e përgjithshme e standardeve të shërbimeve të kujdesit social, kornizë e cila do të plotësohet me standarde specifike për secilën tipologji shërbimi.

Masa 2.3.3 “Prioritizim i një liste standardesh minimale kombëtare dhe koordinim i procesit për vendosjen e tyre.” Kjo masë ende nuk është realizuar.

Masa 2.3.4” Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të arsimit parashkollor dhe kostimi i tyre”. Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit se nga ana e “ASCAP”, janë hartuar standartet e zhvillimit dhe të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç. Janë hartuar standartet profesionale të mësuesit të arsimit parashkollor.

Masa 2.3.5 “Përcaktimi i kostove për njësi për shërbimet e kujdesit social si edhe hartimi i standardeve të reja dhe riorganizimi i standardeve ekzistuese në fushën e shërbimit të kujdesit social” sipas MSHMS ka përfunduar përcaktimi i formulës së përlllogaritjes së kostos/njësi shërbimi, por me përcaktimin e standardeve specifike infrastrukture për tipologji shërbimi do të fillojë zbatimi i formulës. Për vitin 2023-2024 janë hartuar dhe miratuar 4 standarde të reja shërbimesh.

Masa 2.3.6” Hartimi dhe miratimi i paketës së plotë të standardeve minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve UKN”. Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë, se shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve janë ende në proces ristrukturimi.

Masa 2.3.7 “Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të mbetjeve dhe kostimi i tyre”. Në lidhje me këtë masë është raportuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit se me mbështetjen e programit zvicerian për zhvillim lokal dhe decentralizim (DLDP) hartoi dhe miratoi VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” e cila rregullon dhe standardizon llogaritjen e kostove dhe tarifave me qëllim që të arrihet përmbushja e parimit “ndotësi paguan”. Zbatimi i dokumentit është detyrim për bashkitë dhe zbatimi ka nisur që nga viti 2018. Masa 2.3.8 “Studim fizibiliteti për standardet minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve të transportit publik vendor dhe politikat sociale (tarifat e lehtësuara)”. Konkretisht MIE është në zbatim të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2024-2026 dhe referuar Transportit Rrugor janë në proces të përafrimit të Direktivës së BE-së 2009/33/KE “Për mjetet e pastra” e cila është në proces të draft- VKM-së për promovimin e automjeteve me emetim të ulët, në shërbimet publike dhe në transportin e udhëtarëve.

Masa 2.3.8 “Studim fizibiliteti për standardet minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve të transportit publik vendor dhe politikat sociale (tarifat e lehtësuara)”. Konkretisht MIE është në zbatim të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2024-2026 dhe referuar Transportit Rrugor janë në proces të përafrimit të Direktivës së BE-së 2009/33/KE “Për mjetet e pastra” e cila është në proces të draft- VKM-së për promovimin e automjeteve me emetim të ulët, në shërbimet publike dhe në transportin e udhëtarëve.

Masa 2.3.9 “Hartimi dhe miratimi i standardeve për ndërtimin dhe funksionimin e stacioneve multimodale të mjeteve të transportit publik vendor”. Ka raportim nga MIE se për sa i përket zhvillimit të mekanizmave rregullatorë dhe financiare për bashkëpunim ndërvendor, në transportin publik qytetas, kjo pjesë nuk përfshihet në fushën e veprimtarisë së MIE, pasi transporti publik qytetas është kompetencë e pushtetit vendor.

Masa 2.4.1 “Ndërtimi i një sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm”. Me urdhrin e Kryeministrit nr.17, datë 20.2.2023, i ndryshuar është ngritur grupi i punës për krijimin e infrastrukturës elektronike të sistemit për matjen e performancës së bashkive si dhe është krijuar sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm. Ky sistem do të shërbejë për matjen e performancës së NJVV-ve për vitin 2023.

Masa 2.4.2 “Përshtatja e kuadrit normativ për ndërtimin e një sistemi të bazuar në performancë”. Në lidhje me këtë masë janë miratuar treguesit e performancës si dhe metodologjia e raportimit të përcaktuara në urdhrin e Kryeministrit nr.17, datë 20.2.2023, të ndryshuar.

Masa 2.4.3 “Hartimi i udhëzuesve për ngritjen e Njësive të Performancës në nivel bashkie dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e tij”. Në lidhje me këtë masë, konstatohet se deri në dhjetor të vitit 2023, 57 bashki kanë krijuar strukturën e matjes së performancës, bazuar në rekomandimin e bërë nga AMVV.


5.3 QP3: Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre

Statusi i zbatimit të qëllimit të tretë politik të agjendës së strategjisë, është realizuar në masën **60%**. Në figurën e mëposhtme paraqiten 2 objektivat specifik për QP.3 me masat përkatëse të detajuar në numër dhe përqindje realizimi total për çdo masë që ka objektivi specifik. Realizimi i këtij qëllimi mund të cilësohet shumë i mirë në realizueshmëri të produkteve në funksion të këtij qëllimi politik.


Figura 6: Statusi i zbatimit të dy objektivave specifike në QP3

Objektivi Specifik	3.1	3.2
E pa gjurmuar	0	0
Pa filluar	0	6
Me vonesë	0	4
Në kohë	0	0
Përfunduar	1	1
Gabim	0	0
Realizimi në përqindje (%)	100%	20%
Statusi i Objektivit	Shumë mirë	Mirë

Grafiku 12: Statusi i zbatimit të dy objektivave specifike në QP3



Grafiku 13: Zbatueshmëria e masave të QP3



Masa e vetme e objektivit specifik 3.1 e cila lidhet me vlerësim e praktikave, nevojave dhe gatishmërisë digjitale të bashkive dhe publikut është e realizuar në vlerën e 100%. Kjo masë ka si institucion përgjegjës AMVV, e cila afatin e fillimit dhe të mbarimit e ka gjatë vitit 2023.

Gjithë pjesa tjetër e masave pritet të fillojnë prej AKSH-it, e cila po zbaton “Programin për përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”, me Bankën Botërore, e cila mbështet Agjendën Digjitale 2022-2026 të Qeverisë Shqiptare. Ky bashkëpunim vjen në kuadër të përmirësimit të aksesit të qytetarëve dhe bizneseve si dhe të cilësisë së shërbimeve publike elektronike.

Për vitet e ardhshme sipas AKSH-it, do të punohet duke ndjekur platformat moderne të të dhënave dhe teknologjive digjitale për t’iu përgjigjur nevojave të qytetarëve, kapërcimin e mungesës së burimeve dhe përshtatjen me mënyrën e re të punës në distancë duke avancuar më tej me digjitalizimin e shërbimeve.

Aktualisht, AKSHI është duke negociuar me Bankën Botërore me qëllim financimin shtesë për të zgjeruar operacionin e përbashkët ekzistues për digjitalizimin e qeverisjes vendore.

Në këtë kuadër janë identifikuar për t’u financuar nga Banka Botërore projekte me fokus të rëndësishëm në ri-inxhinierimin administrativ, transformimin digjital, modernizimin dhe digjitalizimin e financave vendore, si dhe konkretisht në digjitalizimin e shërbimeve të qeverisjes vendore dhe integrimin e qeverisjes vendore në infrastrukturën digjitale të qeverisë qendrore.

Në lidhje me masën 3.2.5 “Sistemi e-gjopa për policinë bashkiake” raportohet se deri në fund të vitit 2023, është përshtatur sistemi dhe janë lidhur marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për aplikimin e gjobave bashkiake në sistemin e-gjopa të policisë së shtetit.


5.4 QP4: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale

Figura 7 paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 8 masa nuk kanë filluar ende, ndërkohë që rreth 11 masa janë në proces realizimi, si dhe 2 masa të realizuara plotësisht. Statusi total i zbatimit i përlogaritur në përqindje paraqitet me zbatueshmëri të mirë në vetëm **43% realizim**.


Figura 7: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4

Objektivi Specifik	4.1	4.2	4.3	4.4
E pa gjurmuar				
Pa filluar	0			3
Me vonesë	3	2		2
Në kohë	7	1	1	
Përfunduar	1			1
Gabim				
Realizimi në përqindje (%)	49%	30%	70%	22%
Statusi i Objektivit	Mirë	Mirë	Shumë mirë	Mirë

Grafiku 14: Statusi i zbatimit të katër objektivave specifike në QP4



Grafiku 15: Zbatueshmëria e masave të QP4



Përgjegjësinë kryesore për raportimin lidhur me masat e këtij qëllimi politik e ka Ministria e Financës.

MF ka raportuar se lidhur me masën 4.1.1 “Rritja e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme”, aktualisht taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga: taksa mbi ndërtesat, taksa mbi truallin dhe taksa mbi tokën bujqësore. Nga të dhënat e dërguara nga bashkitë, të ardhurat totale të arkëtuara nga taksa mbi ndërtesat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 4.467.652.958 lekë. Në total, nga të dhënat e raportuara nga bashkitë, të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme për vitin 2023 janë 5,57 miliardë lekë.

Masa 4.1.2 “Popullimi dhe përditësimi i kadastrës fiskale”: Kadastra Fiskale përmban të dhëna në nivel kombëtar për qëllimet e llogaritjes së taksës mbi pasuritë e paluajtshme. Popullimi i vazhdueshëm i të dhënave në Kadastrën Fiskale është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore. Në Kadastrën Fiskale janë regjistruar të dhëna për 1,2 milion njësi pronësore, nga të cilat për 412.088 njësi pronësore është regjistruar informacioni i plotë. Nga totali i të dhënave për njësitë pronësore të regjistruara, numri i këtyre njësive të taksueshme është 797.331 njësi. Për sa i përket nivelit të përdorimit të Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale (SIKF) prej NJVV-ve, nga të dhënat rezulton se aktualisht në sistem kanë të hapur një llogari rreth 128 (njëqind e njëzet e tetë) përdorues. Megjithatë nivelet e përdorimit dhe popullimit me të dhëna te SIKF nga ana e bashkive janë të ulëta.

Lidhur me masën 4.1.3 “Miratimi i ligjit dhe kuadrit rregullator për taksën e pasurisë së paluajtshme” në kuadër të reformës për modernizimin dhe forcimin e sistemit të taksimit të pasurisë së paluajtshme”, MF në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe Agjencinë Suedeze të Taksave kanë hartuar projektligjin “Për taksën mbi pasurinë

e paluajtshme”. Ky projektligj i është nënshtruar procesit të konsultimit publik me universitetet, bashkitë, bizneset dhe shoqatat dhe projektet që në fokusin e tyre kanë qeverisjen vendore.

Masa 4.1.4 “Ngritja e një sistemi monitorimi për taksën e pasurisë së paluajtshme”, drejtorja e përgjithshme e taksës së pasurisë në varësi të ministrit përgjegjës për financat një ndër misionet e saj kryen monitorimin dhe asistimin e NJVV-ve për procedurat e ndjekura në llogaritjen e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme, me qëllim zbatimin e metodave të vlerësimit të vlerës së taksueshme, të përcaktuara në metodologjinë, si dhe kryen analizimin e procesit të mbledhjes së taksës vendore mbi pasuritë e paluajtshme nga NJVV-të, si dhe kërkon informacion periodik mbi të ardhurat e realizuara nga taksa e pasurive të paluajtshme.

Masa 4.1.6 “Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, MF thekson se në zbatim të gjurmës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfituese të 2% nga TAP që realizohen në juridiksionin e tyre. Ministria e Financave çdo 4 (katër) muaj pas publikimit të treguesve fiskalë do t’i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerën takuese për t’u shpërndarë sipas bashkive. Kriteri i shpërndarjes së TAP për çdo bashki do të jetë numri i popullsisë së përdorur për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2023. Në këtë kuadër, në vitin 2023 janë akorduar në total 1.153.333.400 lekë TAP për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në funksion të masës 4.1.7 “Hartimi i Udhëzimit dhe mënyrën e përlllogaritjes së ndarjes midis njësive të vetëqeverisjes vendore të ardhurave nga TAP” MF ka raportuar se në udhëzimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2023, është shtuar një pjesë për shpërndarjen e TAP çdo 4-mujor. Ndërkohë aktualisht shpërndarja e TAP është e përcaktuar në udhëzimin e zbatimit të buxhetit.

Në lidhje me masat 4.1.8 “Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme (ndërlidhja) në sistemin informatik të administratës tatimore qendrore për të mundësuar identifikimin e plotë të rezidencës së tatimpaguesve” dhe 4.1.9 “Ndryshimi i kuadrit ligjor për të reflektuar rritjen e pjesës takuese të njësive të vetëqeverisjes vendore nga renta minerare nga niveli aktual prej 5% në 8%”, MF raporton për ngritjen e grupeve të punës, të cilët kanë zhvilluar diskutimet rreth këtyre masave.

Masa 4.1.10 “Ngritja e një sistemi raportimi dhe rakordimi midis administratës qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për masën e rentës minerare të pagueshme”, MF gjatë vitit 2023 ka vazhduar me shpërndarjen e rentës minerare bazuar në akt-rakordimet midis njësive vendore dhe tatimeve/doganave.

Masa 4.1.11 “Studim fizibiliteti për ndarjen e të ardhurave nga tatimet e tjera kombëtare (taksat e përbashkëta)”. Nga MF është raportuar se masa është ende në fazë diskutimi.

Masa 4.1.14 “Studim fizibiliteti për sistemin MIS të unifikuar të tatimeve (TAIS), përfshirë modul për menaxhimin financiar të aseteve”. Kjo masë është ende në fazë diskutimi.

Në lidhje me masën 4.2.1 “Integrimi i transfertave specifike në transfertën e pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) për menaxhimin e funksioneve. Transferimi i granteve të përgjithshme dhe granteve sektoriale”, aktualisht nga raportimi i MF, transfertat specifike i akordohet NJVQV-ve në formën e transfertës së pakushtëzuar (si transfertë sektoriale).

Sa i përket masave 4.2.2 “Hartimi i një studimi mbi funksionet vendore që financohen me transfertat të kushtëzuara, nevojat e bashkive për financim dhe mundësitë e financimit” dhe 4.2.3 “Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me grante të kushtëzuara të funksioneve vendore apo projekteve kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ndodhen në fazën e diskutimit me AMVV dhe FSHZH.

Nga raportimi i masës 4.3.1 “Financimi nëpërmjet huamarrjes së njësisve të qeverisjes vendore”, bazuar në ligjin “Për financat vendore” i ndryshuar, NJVV-të mund të aplikojnë në bankat e nivelit të dytë për të marrë hua.

Për masën 4.4.1 “Studimi i fizibilitetit për AFMIS vendor: përcaktimi i kërkesave funksionale dhe proceseve të biznesit”, është hartuar një draft dokument për mënyrën se si duhet të funksionojë AFMIS në nivel vendor. Gjithashtu nga MF është ngritur edhe grupi i punës për monitorimin e këtij procesi.

Masa 4.4.2 “Hartimi i konceptit të detajuar për AFMIS dhe detajimi i zgjidhjes dhe termat e referencës për ndërtimin e sistemit”. Kjo masë është ende në fazë diskutimi.

Raportimi i masës 4.4.9 “Vlerësimi i kostove dhe miratimi i një akti ligjor (VKM) për regjistrimin dhe dhënien pa pagesë me modalitete të lehtësuara të informacionit tek NJVV-të lidhur me asetet publike vendore dhe vendosjen e barrave siguroese mbi pronat” nga ASHK thekson se NJVV-të për të gjitha shërbimet që aplikojnë në ASHK tarifohen sipas VKM nr.389 datë 13.5.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale.

Masa 4.4. 11 “Përfshirja në SIFQ e kërkesave të NJVV për kontabilitetin rritës, menaxhimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe raportet financiare periodike dhe vjetore. Përkon me procesin e zhvillimit /zgjerimit të mëtejshëm të SIFQ”. Nga Ministria e Financës raportohet se do të realizohet zhvillimi i sistemit SIFQ bazuar në nevojat e identifikuara të përgatitura gjatë fazës së parë të projektit të BB-së “Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (IPSAS)” ku do të mundësojë përshtatjen e sistemit me metodologjinë e re kontabël, përmirësimin e konfigurimeve ekzistuese që sigurojnë regjistrimet kontabël dhe raportimin financiar si dhe automatizimin e proceseve të hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara (brenda vitit 2027).

Masa 4.4.12 “Vlerësimi i aspekteve teknike për ndarjen e llogarive vendore në Llogari të Unifikuar të thesarit”. Në lidhje me këtë masë është kryer vlerësimi nga Ministria e Financave dhe po përgatitet dokumentacioni i nevojshëm për plotësimin e kësaj mase.

Masa 4.4.13” Identifikimi (ndarja) e llogarive vendore”, nuk është raportuar ecuri në lidhje me këtë proces nga MF, pasi realizimi i saj nuk ka filluar ende.

QP 5: Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor


Figura 8 paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 2 masa nuk kanë filluar ende zbatimin, ndërkohë që rreth 3 masa janë në proces realizimi si dhe 3 masa janë realizuar plotësisht. Statusi total i zbatimit i

përlogaritur në përqindje paraqitet në **vlërën 66%**, duke e cilësuar një qëllim politik me realizueshmëri të mirë për kohëzgjatjen e planit të veprimit.


Figura 8: Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike në QP5

Objektivi Specifik	5.1	5.2	5.3
E pa gjurmuar	0	0	0
Pa filluar	1		0
Me vonesë	1		
Në kohë	1		2
Përfunduar	0	1	2
Gabim	0	0	0
Realizimi në përqindje (%)	23%	100%	75%
Statusi i Objektivit	Mirë	Shumë mirë	Shumë mirë

Grafiku 16: Statusi i zbatimit të tre objektivave specifike të QP5



Grafiku 17: Zbatueshmëria e masave të QP5



Masa 5.1.1 “Konsolidim i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore dhe administrative në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore (kompetencat e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik dhe vendimarrja e qytetarit)”. Përgjatë vitit 2023 janë zhvilluar trajnime me këshillat e njësisive të vetëqeverisjes vendore për qartësimin e rolit të tyre në proceset e ushtrimit të detyrës.

Masa 5.1.2 “Ndërtimi i një mekanizmi nxitës për rritjen e efikasitetit të Këshillave Bashkiakë duke pasur parasysh performancën e tij, komisionet bashkiake dhe aspekte të tjera lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, duke marrë në konsideratë integrimin me bazë gjinore”. Kjo masë është ende në proces, pasi duhet hartuar një kuadër i qartë për performancën e Këshillave Bashkiakë në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien.

Masa 5.1.3 “Forcimi i kapaciteteve të Këshillave Bashkiakë dhe inkurajimi i shkëmbimit të praktikave të mira mbi transparencën, llogaridhënien dhe vendimarrja mbi bazën e parimit të subsidiaritetit”. Përgjatë vitit 2023, janë zhvilluar trajnime në lidhje me praktikat më të mira të transparencës, llogaridhënies dhe vendimarrjes. Në lidhje me këtë masë Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me ASPA dhe projektin “BtF” gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2023, ka zhvilluar trajnime me synim qartësimin e rolit ligjor të këshillit bashkiak ku 81% e këshilltarëve të trajnuar ishin zgjedhur për herë të parë.

Masa 5.2.1 “Koordinimi dhe bashkërendim me NJVV për hartimin e planeve të integritetit dhe Kodit të Sjelljes”. Në lidhje me zbatimin e kësaj mase Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka koordinuar punën në hartimin e planeve të integritetit për bashkitë Lushnje, Librazhd dhe Roskovec.

Për masën 5.3.1 “Forcimi i rolit të Njësive të BE-së për të koordinuar dhe marrë pjesë në proceset e zhvillimit të politikave bashkiake”, ASPA në bashkëpunim me projektin ‘Bashkitë për në Evropë’ ka zhvilluar gjatë vitit 2023, 4 trajnime rajonale për strukturat e Integritetit Evropian me 92 pjesëmarrës nga stafet e reja të Njësive të Integritetit nga 61 bashkitë e vendit.

Gjithashtu lidhur me shtrirjen e procesit të Integrimit përtej Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, ASPA në bashkëpunim me projektin “BpE”, zhvilloi 22 trajnime rajonale me 678 pjesëmarrës në total, dedikuar rritjes së kapaciteteve të Strukturave të Integrimit Evropian pranë bashkive me tematika:

- Procesi i negociatave dhe roli i bashkive;
- Shkrimi i Suksesshëm i Projekt Propozimeve në bazë të thirrjeve të hapura në Programet Evropiane Horizon Europe dhe Binjakëzimi i Qyteteve (CERV);
- Trajnimi Rajonal për PRAG – Procedurat e Prokurimit të BE-së;
- Trajnimet Rajonale me Sekretarët e Përgjithshëm, Nënkyetarët, trupën menaxheriale të bashkive.

Masa 5.3.2 “Shtrirja e proceseve të integrimit në BE përtej njësive të BE, duke siguruar përfshirjen dhe kontributin e duhur të gjithë administratës vendore”. Në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë, janë zhvilluar sesione trajnimesh me administratën vendore për të bërë të mundur njohjen e proceseve të integrimit dhe nga strukturat e tjera bashkiake.

Për sa i përket masës 5.3.3 “Zhvillimi i udhëzimeve ndihmuese për administratën vendore lidhur me agjendën e integrimit evropian në nivel vendor”, ASPA në bashkëpunim me AMVV dhe projektin BPE kanë prodhuar gjatë vitit 2023:

- Raporti i vitit 2022 për Ecurinë e Bashkive në Procesin e Integrimit Evropian,
- Raporti i Projekteve të financuara nga Donatorët për Bashkitë,
- Skeda e Procesit të Negociatave.

Lidhur me masën 5.3.4 “Krijimi i një sistemi monitorimi dhe raportimi për projektet e zbatuara nga NJVV”, bashkitë kanë raportuar se 45 prej tyre përdorin një sistem raportimi shkresor ose elektronik.


5.6 QP6: Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit

Figura 9 paraqet situatën e zbatimit të masave në kuadër të këtij qëllimi strategjik dhe shkallën e realizimit të tyre. Siç shihet, 11 masa janë jashtë afatit me ecurinë sipas planit të veprimit, ndërkohë që 10 masa janë në proces realizimi dhe 2 masa janë realizuar plotësisht. Statusi total i zbatimit i përllogaritur në përqindje paraqitet në **vlërën 30%**, duke e cilësuar një qëllim politik me realizueshmëri të dobët për kohëzgjatjen e planit të veprimit.


Figura 9: Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike të QP6

Objektivi Specifik	6.1	6.2	6.3	6.4	6.5
E pa gjurmuar					
Pa filluar	2	2	1	1	2
Me vonesë	3	1		1	1
Në kohë	6	1			
Përfunduar		1	1		
Gabim					
Realizimi në përqindje (%)	48%	34%	50%	10%	7%
Statusi i Objektivit	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë

Grafiku 18: Statusi i zbatimit të pesë objektivave specifike në QP6



Grafiku 19: Zbatueshmëria e masave të QP6



Në lidhje me masën 6.1.1 të “Vlerësimit kombëtar për trajnim të vazhdueshëm bazuar në nevoja”, ASPA është e angazhuar për mbështetjen e administratës vendore me trajnime që kanë në fokus përmbushjen e detyrave funksionale, arritjen e objektivave konkrete të punës, si edhe zhvillimin personal të individëve. Për këtë arsye ka zhvilluar procesin e vlerësimit të nevojave

për trajnim për vitin 2023 dhe ka pasqyruar nevojat e mbledhura në kalendarin e trajnimeve 2023-2024.

Referuar masës 6.1.2 lidhur me krijimin e Akademisë së Pushtetit Vendor me iniciativë të Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor për fuqizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës, me Urdhër të Kryeministrit nr.6 datë 12.01.2024 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të zgjedhurve vendor”. Kjo është një masë që realizueshmërinë e plotë do e ketë gjatë raportimit të vitit 2024, por vlen të theksohet këtë vit arritja e konsolidimit të kësaj nisme. Duke marrë në konsideratë që ngritja e Akademisë së Pushtetit Vendor parashikohet gjatë vitit 2024, grupi i punës ka dakordësuar që viti 2024 të jetë një vit tranzitor ku AMVV do të jetë institucioni përgjegjës për koordinimin e iniciativave për ofrimin e trajnimeve, bazuar në detyrat funksionale të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për organizimin dhe funksionimin e AMVV. Pranë agjencisë është ngritur Drejtoria e Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve, e cila ka në fokusin kryesor asistencën dhe mbështetjen për NJVV-të, duke zhvilluar trajnime në bazë të nevojave të pushtetit vendor, ofruar asistencë teknike, shpërndarë praktika të mira si dhe zhvilluar platformën e njohurive. Gjatë periudhës raportuese AMVV në bashkëpunim me projektin BPE kanë përfunduar ciklin e trajnimeve për procedurat e prokurimeve sipas rregullave të BE-së, i cili ka filluar gjatë vitit 2023.

Në lidhje me masën 6.1.3 “Analiza e nivelit të pagave dhe rishikimi (rritja) e nivelit të pagave të nëpunësve në NJVV, për të siguruar qëndrueshmëri të nëpunësve ekzistues dhe tërheqjen e nëpunësve të rinj të talentuar dhe profesionistë”, është realizuar gjatë vitit 2023 me miratimin e vkm-së për nivelin e pagave, me vendimin nr. 328, datë 31.05.2023.

Në lidhje me masën 6.1.4” Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve publikë përmes zbatimit të programeve të trajnimit dhe internship-it, dedikuar nëpunësve civilë të rinj”, gjatë vitit 2023 në kuadër të këtij programi u organizuan këto aktivitete:

- Në 17 maj, në një aktivitet të dedikuar, u prezantua programi më i ri, “Young Cells.
- Përcaktimi i kriterëve për përzgjedhjen; zhvillimi i testimit; intervistave dhe përzgjedhja e fituesve u zhvilluan midis muajve Qershor-Korrik 2023.
- Në 21 Shtator u zhvillua ceremonia e prezantimit të 25 kandidatëve fitues të përzgjedhur në kuadër të projektit “Young Cells Albania”.

Masa 6.1.5 “Vlerësim për përmirësimin e funksionaliteteve të platformës “Administrata.al”, për të reflektuar nevojat e institucioneve përfshirë dhe nivelin vendor për një menaxhim të unifikuar të burimeve njerëzore”, është masë e cila ka si institucion përgjegjës Departamentin e Administratës Publike dhe nga raportimi rezultoi të jetë në proces.

Masa 6.1.6 “Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për përdorimin e platformës “Administrata.al” për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave për trajnim të stafit në nivel qendror dhe vendor dhe hartimi i planit të trajnimeve për NJVV mbi përdorimin e portalit “Administrata.al”, është masë e cila ka si institucion përgjegjës Departamentin e Administratës Publike dhe nga raportimi rezultoi të jetë në proces.

Masa 6.1.7 “Ngritja e kapaciteteve të Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të NJVV-ve për përdorimin e platformës "Administrata.al" përmes trajnimeve dhe asistimit përmes help-desk të ngritur pranë DAP”, nga raportimi i Departamentit të Administratës Publike, theksohet

se pas ndryshimeve që do të pësojë platforma në funksionalitetet e saj do të vijohet me hartimin e një plani veprimi për ngritjen e kapaciteteve.

Masa 6.1.8 “Rritja e përdorimit të funksionaliteteve të platformës "Administrata.al", për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e NJVV përfshirë dhe raportimin periodik, nga ana e DAP raportohet se lidhur me rritjen e përdorimit të platformës së integruar të bashkëpunimit Administrata.al, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “ Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri”, financuar nga qeveria gjermane, DAP dhe KMSHC, parashikojnë të ndërmarrin disa masa si zhvillimi i trajnimeve me përdoruesit e platformës, përgatitja e video tutorialeve për përdorimin e funksionaliteteve specifike të platformës si një help desk të dedikuar për të mbështetur nëpunësit, sidomos ato në nivel vendor. Të gjitha elementët e sipërpërmendur do të zhvillohen gjatë tremujorit të fundit të vitit 2024. Platforma administrata.al, sëbashku me Sistemin e Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) janë pjesë e një ndërhyrje nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila pritet të finalizohet në Shtator të vitit 2024, çka do ti hapë rrugë trajnimeve me nëpunësit e nivelit qendror dhe vendor.

Masa 6.1.9 “Hartimi dhe integrimi i kuadrit/kornizës së kompetencave për burimet njerëzore të NJVV në planin e trajnimit të ASPA-ës”, Departamenti Administratës Publike ka raportuar se me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri”, financuar nga qeveria gjermane, është hartuar një raport rekomandimesh sa i takon zhvillimit të një kuadri kompetencash për nëpunësit civil në nivel qendror dhe vendor. Ky raport është diskutuar me përfaqësues të njësive të burimeve njerëzore në mbledhjen e rrjetit profesional të burimeve të zhvilluar në Nëntor të vitit 2023. Aktualisht është hartuar një draft kuadër kompetencash thelbësore për nëpunësit civil në nivel vendor duke marrë si shembull Bashkinë Tiranë. Ky draft kuadër do të diskutohet në mbledhjen e rradhës të rrjetit të burimeve njerëzore.

Masa 6.1.10 “Hartimi i strategjisë/planit për zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të NJVV-ve në 61 bashkitë dhe 12 këshillat e qarqeve”, theksojmë se me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “ Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri”, financuar nga qeveria gjermane, është hartuar një raport rekomandimesh lidhur me përmirësimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnim të zhvilluar nga ASPA, me qëllim kryerjen e një procesi sa më gjithëpërfshirës dhe efikas. Ky raport synon të udhëheqë transformimin e procesit në digjital, nisur nga fakti që synimi është që procesi i vlerësimit të nevojave për trajnim të bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet modulit të vlerësimit të nevojave për trajnim, modul i cili gjithashtu po përditësohet me mbështetjen e projektit, për të patur rezultate me efektive dhe të besueshme. Gjithashtu Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta, zhvilluan gjatë vitit 2023 trajnimin e anëtarëve të këshillave bashkiakë me 13 trajnime në rang vendi mbi detyrat e këshilltarëve vendorë dhe 861 pjesëmarrës të certifikuar.

Masa 6.1.11 “Krijimi i modeleve të matjes së performancës në nivel vendor bazuar në rezultate krahasimore”. Për nëpunësit me status nëpunësi civil janë hartuar dhe miratuar modulet për matjen e performancës.

Masa 6.2.1 “Identifikim dhe vlerësimi i marrëdhënieve dhe roleve të institucioneve qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore”. Përgjatë vitit 2023 nëpërmjet Këshillit Konsultativ, është kryer analizë për marrëdhëniet dhe rolet e institucioneve qendrore në mbështetje të vetëqeverisjes vendore. Nisur nga ky dokument, në vitin 2024, është amenduar

vendimi i Këshillit të Ministrave për Këshillin Konsultativ, duke plotësuar kuadrin institucional, në mbështetje të qeverisjes vendore.

Masa 6.2.2 “Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe AMVV për vlerësim, monitorim dhe zbatim të agjendës së decentralizimit”, evidenton se kompetencat kryesore koordinuese dhe raportuese të agjendës së decentralizimit për shkak të përditësimit të legjisllacionit, i ngarkohen AMVV. Viti 2023 shënon edhe vitin e parë të realizimit të raportit të monitorimit të strategjisë së decentralizimit dhe qeverisjes vendore nga agjencia.

Masa 6.2.3 “Forcimi i rolit të Grupit Tematik të Decentralizimit në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët”. Kjo masë është realizuar përgjatë vitit 2023, duke ridimensionuar koordinimin me donatorët. Në takimet e zhvilluara me pjesëmarrjen e SASPAC, janë qartësuar nevojat dhe problematikat që duhet të adresohen sipas agjendës së decentralizimit.

Masa 6.2.4 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të funksionimit të Këshillit Konsultativ për rritjen e rolit të tij proaktiv nën dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore” dhe masa 6.2.5 “Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ në përforcimin e dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore”. Me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.244, datë 17.4.2024, u rikonceptua mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit konsultativ me vetëqeverisjen vendore. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte forcimi i rolit të KK në përforcimin e dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, si edhe rritja e rolit të qeverisjes vendore në procesin konsultues të projektakteve lidhur me standardet e shërbimeve vendore. Gjatë vitit 2023 në Këshillin Konsultativ kaluan 59 projektakte.

Masa 6.3.1 “Vlerësimi i gatishmërisë për decentralizim të mëtejshëm sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta bashkiake”. Në lidhje me këtë masë, përgjatë vitit 2023, është përgatitur draft-urdhri i Kryeministrit lidhur me këtë qëllim. Në muajin maj 2024, është miratuar urdhri i Kryeministrit nr.81 për aplikimin e mekanizmit të decentralizimit horizontal dhe janë zhvilluar 3 takime konsultuese midis Ministrive dhe bashkive të përzgjedhura për vlerësimin e decentralizimit të përgjegjësive që ushtrohen nga institucionet qendrore.

Masa 6.3.2 “Vlerësim dhe ridimensionim të rolit të qarqeve në kuadër të zhvillimit ndër-rajonal, nder to identifikimi i fushave me potencial për ekonomi shkalle”. AMVV ka vlerësuar rolin e qarqeve, në kuadër të zhvillimit rajonal. Në lidhje me përgjegjësitë dhe funksionet që mund të shtohen në institucionin e Këshillit të Qarkut, lind nevoja për amendimin e ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

Masa 6.4.1 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të institucionit të prefektit”.

Në lidhje me zbatimin e kësaj mase është parashikuar hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” në katër mujorin e parë të vitit 2024.

Lidhur me masën 6.4.2 “Forcimi i monitorimit dhe rritja e bashkëpunimit të institucionit të prefektit me degët territoriale, përfshirë edhe rolin në monitorimin e standardeve kombëtare” nuk është aplikuar, pasi hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” është parashikuar në katërmujorin e parë të 2024.

Masa 6.5.1 “Ofrimi dhe ndarje e njohurive/eksperiencave nga shoqatat”. Në lidhje me këtë masë Shoqata për Autonominë Vendore, përgjatë vitit 2023, ka ndarë me bashkitë 3 praktika të mira të bashkive, Vlorë, Lezhë dhe Berat, të cilat mund tu shërbejnë bashkive të tjera për përmirësimin e shërbimeve.


Masa 6.5.2 “Ngritja / rijetëzimi pranë shoqatave i forumeve profesionale në ndihmë të ndërveprimit mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore” dhe Masa 6.5.3 “Konsolidimi i mekanizmit të Konkursit të Praktikave të Mira dhe inkurajimi me çmime”, nuk kanë patur zhvillime për vitin 2023.

Në tërësi qëllimet politike kanë një realizim prej 48%, ku 8 objektiva specifike kanë ecuri shumë të mirë, 13 ndodhen në proces realizimi dhe vetëm një objektiv është mbrapa planit të veprimit për realizim.

Figura 10: Përmbledhëse e statusit të 22 objektivave specifike

Statusi i Objektivit	Numri
Dobët	0
Mirë	13
Shumë Mirë	9
Total	22

Grafiku 20: Totali i objektivave specifike



Rekomandime dhe konkluzione

Zhvillimi i plotë i sistemit të monitorimit dhe raportimit të strategjisë në praktikë, mund të marrë kohë, përpara se t'i shërbejë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efektive qëllimeve të politikëbërjes dhe llogaridhënies për procesin e decentralizimit. Vënia në zbatim e instrumentëve dhe kuadrit të monitorimit do të përmirësojnë me kalimin e kohës thellësinë dhe cilësinë e informacionit të gjeneruar gjatë procesit të monitorimit me synim përfundimtar ndikimin në vendimmarrje.

Gjatë punës së ndërmarrë për përpilimin e kuadrit të monitorimit, për të krijuar kushtet për monitorim të zbatimit të Strategjisë së Decentralizimit, janë evidentuar disa sfida të cilat janë renditur në vijim së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Fuqizimi i rolit horizontal të Qeverisjes Qendrore në monitorimin ndërsektorial të Strategjisë

Strategjia e decentralizimit dhe qeverisjes vendore nënvizon vështirësitë e hasura nga AMVV në përfundimin e raporteve nga ministritë e linjës, konfirmuar edhe gjatë grumbullimit të informacionit për përgatitjen e raportit të monitorimit për vitin 2023. Vështirësitë pasqyrohen si në përcaktimin e koordinatorëve për raportim, ashtu dhe në nivelin e raportimit të plotë dhe në kohë.







- Mjaftueshmëria e financimit dhe buxhetimi

Raportimi nga ministritë e linjës dhe bashkitë dëshmon mungesën e kodeve të programit buxhetor dhe burimeve financiare të dedikuara për zbatimin e masave të planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë. Për rrjedhojë, si procesi i zbatimit ashtu edhe ai i monitorimit të Strategjisë do të ketë mangësi, nëse nuk buxhetohet. Buxhetimi do të dëshmojë rëndësinë e procesit dhe do të mundësojë zbatimin e tij.

Buxhetimi i strategjisë nga institucionet përgjegjëse duhet të ndërmerret si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor. Strukturat monitoruese dhe zbatuese të Strategjisë në nivel qendror, do të ndihmojnë në përfshirjen e strategjisë edhe në procesin e planifikimit vjetor dhe afatmesëm.

Aneks 1. Raportimi i statusit të zbatimit të masave planit të veprimit të Strategjisë

Figura 11: Informacion i përgjithshëm mbi realizueshmërinë e masave

 1	 2	 3	 4	 5	 6
1.1.1	2.1.1	3.1.1	4.1.1	5.1.1	6.1.1
1.1.2	2.1.2	3.2.1	4.1.2	5.1.2	6.1.2
1.1.3	2.1.3	3.2.2	4.1.3	5.1.3	6.1.3
1.1.4	2.1.4	3.2.3	4.1.4	5.2.1	6.1.4
1.1.5	2.2.1	3.2.4	4.1.6	5.2.1	6.1.5
1.1.6	2.2.2	3.2.5	4.1.7	5.2.2	6.1.6
1.2.1	2.2.3	3.2.6	4.1.8	5.2.3	6.1.7
1.2.2	2.2.4	3.2.7	4.1.9	5.2.4	6.1.8
1.2.3	2.2.5	3.2.8	4.1.10		6.1.9
1.2.4	2.2.6	3.2.9	4.1.11		6.1.10
1.2.5	2.2.7	3.2.10	4.1.14		6.1.11
1.2.6	2.2.8	3.2.11	4.2.1		6.2.1
1.2.7	2.2.9		4.2.2		6.2.2
1.2.8	2.2.10		4.2.3		6.2.3
1.2.9	2.2.11		4.3.1		6.2.4
1.3.1	2.2.12		4.4.1		6.2.5
1.3.3	2.2.14		4.4.2		6.3.1
1.3.4	2.2.15		4.4.3		6.3.2
1.3.5	2.2.16		4.4.11		6.4.1
1.3.7	2.2.17		4.4.12		6.4.2
1.3.8	2.2.18		4.4.13		6.5.1
1.3.9	2.2.19				6.5.2
1.3.10	2.2.20				6.5.3
1.3.11	2.2.21				
1.4.1	2.2.22				
1.4.2	2.2.23				
1.4.3	2.2.24				
1.4.4	2.2.25				
	2.2.26				
	2.2.27				
	2.2.28				
	2.2.29				
	2.2.32				
	2.2.33				
	2.2.34				
	2.2.35				
	2.2.36				
	2.2.37				
	2.2.38				
	2.2.39				
	2.2.40				
	2.2.41				
	2.2.42				
	2.2.41				
	2.2.42				
	2.2.43				
	2.2.44				
	2.2.45				
	2.2.46				
	2.2.47				
	2.2.48				
	2.2.49				
	2.2.50				
	2.2.51				
	2.3.1				
	2.3.2				
	2.3.3				
	2.3.4				
	2.3.5				
	2.3.6				
	2.3.7				
	2.3.8				
	2.3.9				
	2.4.1				
	2.4.2				
	2.4.3				

QP. 1

1.1.1 "Përfundimi i procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, rishikimi i planeve të miratuara dhe hartimi i planeve strategjike zhvillimore": Realizueshmëria në masën 80%, ngjyra jeshile.

1.1.2 "Rijetëzimi dhe prezantimi i incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërvendore dhe me aktorë të tjerë joqeveritare": Realizueshmëria në masën 80%, ngjyra jeshile.

1.1.3 "Rishikim i kuadrit ligjor mbi skemat vendore/praktikave ekzistuese të mbështetjes dhe bashkëpunimit me biznese": Realizueshmëria në masën 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

1.1.4 "Qartësim i hapësirave/mbivendosjeve ligjore lidhur me rijetëzimin e shoqërive tregtare": Realizueshmëria në masën 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

1.1.5 "Hartimi i një udhërrëfytyrës për bashkitë mbi mbështetjen e bizneseve vendore me grante apo shërbime të tjera": Realizueshmëria në masën 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

1.1.6 "Identifikimi i vazhdueshëm i praktikave të mira të lidhura me bashkëpunimin bashki-biznes dhe inkurajimi e orientim i bashkive për replikim apo përshtatje sipas rastit": Realizueshmëria në masën 100%, ngjyra jeshile.

1.2.1 "Shfrytëzimi i aseteve vendore, si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim i gjenerimit të të ardhurave. Identifikim, vlerësim dhe klasifikim të pronave të bashkive (inventarizim nga secila bashki)": Realizueshmëria në masën 100%, ngjyra jeshile.

1.2.2 "Strategji/Plan të vënies në përdorim të aseteve vendore nga ana e bashkive (përcaktimin e burimeve financiare dhe politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë/planit)": Realizueshmëria në masën 35%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

1.2.3 "Bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV me qëllim rritjen e ekonomisë vendore": Realizueshmëria në masën 100%, ngjyra jeshile.

1.2.4 "Vlerësimin e mundësisë së lehtësimit të formave të pagesës për regjistrimin e titujve të pronësisë në favor të NJVV-ve dhe një kuadër ligjor të unifikuar dhe të kombinuar me përgjegjësi të qarta të gjithë aktorëve": Realizueshmëria në masën 50%, ngjyra portokalli, masa ndodhet mbrapa afatit të realizimit.

1.2.5 "Rijetëzimi i aseteve natyrore (si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore)": Realizueshmëria në masën 50% ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

1.2.6 "Koordinim ndërbashkiak në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarëshhtimit të pyjeve me qëllim zhvillimin ekonomik vendor": Realizueshmëria në masën 10%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

1.2.7 "Hartim i metodologjisë për vlerësimin e kapitalit natyror" Realizueshmëria në masën 100%, ngjyra jeshile. 100%.

1.2.8 "Vlerësimi i kapitalit natyror për secilën bashki sipas metodologjisë së miratuar": Realizueshmëria 15%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

1.2.9 "Hartim i planit të menaxhimit të kapitalit natyror për secilën bashki": Realizueshmëria 15%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

1.3.1 "Nxitja e rolit të bashkisë për mbështetjen nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR-së": Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

1.3.3 "Nxitja e rolit të bashkive dhe konsolidimi i kapaciteteve të tyre në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, duke e mbështetur edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore, si dhe fuqizimin e bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën

administrimin e MBZHR-së, atyre dytësore dhe tretësore nën kompetencën bashkiake”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

1.3.4 “Organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sigurinë e digave dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, në pronësi të NJVV. (Krijimi dhe konsolidimi i Njësisë Përgjegjëse për Ujitjen dhe Kullimin (NJPUK), ku bën pjesë edhe Njësia e Drejtimit Teknik të Digave)”: Realizueshmëria **85%**, **ngjyra jeshile**.

1.3.5 “Kryerja e studimit të parafisibilitetit të rreth 430 digave për sigurinë e digave dhe përdorimit të tyre për ujitje, mbështetur në studimet e mëparshme (për 195 diga) të sigurisë së digave”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

1.3.7 “Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm të ujitjes në sipërfaqen potencialisht të ujitshme 360,000 ha. (Vazhdimi i ujitjes së qëndrueshme në rreth 250,000 ha me infrastrukturë ujitëse të rehabilituar plotësisht/pjesërisht dhe shtimi i aftësisë ujitëse me rreth 110,000 ha, kryesisht në skemat ujitëse me ngritje mekanike me stacione pompimi)”: Realizueshmëria **59%**, **ngjyra jeshile**.

1.3.8 “Ofrimi i shërbimit të qëndrueshëm të kullimit në sipërfaqen potencialisht të kullueshme në 280,000 ha (Vazhdimi i procesit ciklik vjetor të pastrimit të rrjetit të kanaleve kulluese, të parët nga MBZHR-ja dhe të dytë, e të tretë nga NJVV-të, si dhe përmirësimi teknik i hidrovoreve)”: Realizueshmëria **57%**, **ngjyra jeshile**.

1.3.9 “Përmirësimi i sigurisë së mbrojtjes nga përmbytja. (Nëpërmjet rehabilitimit dhe ndërtimit të argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytja, për tokat bujqësore dhe zonat rurale nga MBZHR-ja dhe zonat urbane nga NJVV)”: Realizueshmëria **70%** **ngjyra jeshile**.

1.3.10 “Performanca e ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit nga NJVV, nëpërmjet popullimit me të dhëna të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Ujitjes dhe të Kullimit nga vetë NJVV (ujitja.al) dhe vlerësimi i performances”: Realizueshmëria **54%**, **ngjyra jeshile**.

1.3.11 “Qartësimi i kompetencave për sanksione administrative direkte për bashkitë në lidhje me shkeljet në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve e kullotave”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

1.4.1 “Fuqizimi i strukturave të turizmit vendor në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor” Realizueshmëria **25%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

1.4.2 “Rishikimi i kuadrit ligjor mbi Trashëgiminë Kulturore”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

1.4.3 “Ngritja e një sistemi/databazë të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor”: Realizueshmëria **20%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

1.4.4 “Aplikimi i instrumenteve inovative si zonat e përmirësimit të biznesit dhe turizmit”: Realizueshmëria **100 %**, **ngjyra jeshile**.

QP2.

2.1.1 “Vlerësim/ Studim mbi efikasitetin e ofrimit të shërbimeve të ushtruara nga bashkitë”: Realizueshmëria **25%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.1.2 “Studim/Analizë e përditësuar e harmonizimit ligjor, duke përfshirë mbivendosjet dhe hapësirat potenciale midis ligjit organik dhe atyre sektoriale”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.1.3 “Harmonizim i ligjeve dhe akteve nënligjore që përcaktojnë marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për forcimin e rolit të NJVV në zbatimin e funksioneve”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.1.4” Përgatitja e manualeve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit (të përzgjedhura) që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV për një ofrim sipas standardeve të shërbimeve”: Realizueshmëria **0%**, **ngjyra e kuqe**, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

2.2.1 “Harmonizimi ligjor për kompetencat e NJVV-ve për shërbimet e UKN”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.2 “Hartimi i planeve 5-vjeçar të biznesit për të gjitha ndërmarrjet rajonale UKN sh. a, në konsultim me NJVV-të”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.3 “Asistencë teknike për NJVV-të për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur, në kuadër të reformës së rajonalizimit të UKN sh.a.”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.4 “Hartimi i kuadrit rregullator për përcaktimin e kriterëve dhe rregullimi i mbrojtjes së burimeve ujore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm”: Realizueshmëria **25%** **ngjyra portokalli**, masa në proces, miratimi i ligjit në prill të vitit 2024.

2.2.5 “Rishikimi i kuadrit rregullator për arsimin me qëllim përfshirjen e vetëqeverisjes vendore në të gjitha proceset e arsimit parashkollor, përmes një procesi gjithëpërfshirës”: Realizueshmëria **40%**, **ngjyra jeshile**, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.6” Avancimi i decentralizimit të funksionit të arsimit parashkollor duke i dhënë kompetenca bashkive a) hartimin e politikave nga qeverisja vendore, b) të përshtatin funksionin me rrethanat vendore dhe c) të përfshijë aktorët lokalë (si këshillat e prindërve) në procesin e vendimmarrjes”: Realizueshmëria **30%**, **ngjyra portokalli**.

2.2.7 “Krijimi i “Konferencës Ndërbashkiake për Arsimin Parashkollor” si organ vendor ose rajonal për të koordinuar bashkitë, (ose si një grup pune i Shoqatave të Bashkive) me qëllim diskutimin e problemeve dhe projekteve të përbashkëta” Realizueshmëria **20%**, **ngjyra portokalli**.

2.2.8 “Përcaktimi i skemës së kompensimit financiar dhe mbulimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit që ndjekin procesin mësimor në institucionet e arsimit parashkollor publike, jashtë vendbanimit”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.2.9 “Rritja e rolit të pjesëmarrjes së prindërve në edukimin parashkollor përmes fuqizimit të bordeve dhe fushatave të dedikuara informuese”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.2.10 “Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për menaxhimin e shërbimit të arsimit parashkollor përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar”: Realizueshmëria **20%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.11 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë mbledhjen e të dhënave (procedurat standarde të veprimit në arsimin parashkollor, vlerësimi i performancës së drejtorëve të kopshtit, planet e përmirësimit të shërbimit, etj.)”: Realizueshmëria **25%** **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.13 “Rishikim i bazës ligjore për lejet e mjedisit për të përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat bashkiake rregullatore dhe monitoruese për aktivitetet industriale që kanë një ndikim relativisht të ulët në mjedis dhe që zhvillohen në zona urbane, jashë zonave industrial”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.2.14 “Rishikimi i kompetencës bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe kompetencës vendore në fushën e mbrojtjes nga ndotja e ajrit, ujit dhe akustike”: Realizueshmëria **100%**, **ngjyra jeshile**.

2.2.15 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për planet vendore të veprimit për mjedisin dhe të cilësisë së ajrit, si dhe strukturat përkatëse”: Realizueshmëria **50%**, **ngjyra jeshile** masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

- 2.2.16 “Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi”: Realizueshmëria **20% ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.
- 2.2.17 “Vlerësim strategjik të mjedisit të secilës bashki (identifikim i problemeve mjedisore, përditësim i zonave të ndjeshme ku ndodhen ndërtesat me kërkesa të veçanta për nivelin e zhurmave, përcaktim i objektivave vendore të mjedisit për secilën bashki, etj.)”: Realizueshmëria **31%, ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.
- 2.2.18 “Nisma për edukimin ambientaal të komunitetit (rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, hedhjen e tyre me orar si edhe përdorimi i çantave ekologjike të riciklueshme, të cilat përmirësojnë dhe mbrojnë mjedisin urban)”: Realizueshmëria **100% ngjyra jeshile**.
- 2.2.19” Studimi për përcaktimin e zonave të mbetjeve dhe modelit institucional të qeverisjes dhe organizimit të Zonave të Mbetjeve dhe rolin e NJVV-ve”: Realizueshmëria **50%, ngjyra jeshile**, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.
- 2.2.20 “Studim dhe asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve përfshirë dhe rishikimin e kuadrit rregullator”: Realizueshmëria **0%, ngjyra e kuqe**, masa nuk ka nisur ende të realizohet.
- 2.2.21 “Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë edhe mbledhjen e diferencuar dhe riciklimin (planet e menaxhimit të mbetjeve, paketa fiskale, etj.)”: Realizueshmëria **100 %, ngjyra jeshile**.
- 2.2.22 “Hartimi i kuadrit rregullator për zbatueshmërinë e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për bashkitë dhe qarqet”: Realizueshmëria **20% ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.
- 2.2.23” Konceptimi dhe hartimi i masave nxitëse fiskale dhe financiare për aktivitetet ricikluese dhe kompostuese në nivel vendor”: Realizueshmëria **100%, ngjyra jeshile**.
- 2.2.24 “Fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për mobilizimin e komunitetit për ndarjen në burim dhe monitorimin e cilësisë së shërbimit”: Realizueshmëria **100 %, ngjyra jeshile**.
- 2.2.25 “Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial për menaxhimin e shërbimit të mbetjeve përmes një kurrikule dhe sistemi certifikimi të njehsuar”: Realizueshmëria **20%, ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.
- 2.2.26 “Hartimi i raportit të vlerësimit për mbikëqyrjen së sigurisë e digave dhe rolin e NJVV”: Realizueshmëria **100 % ngjyra jeshile**.
- 2.2.27 Harmonizimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve ujore vendore”: Realizueshmëria **100%, ngjyra jeshile**.
- 2.2.28 “Harmonizimi i kuadrit rregullator për transportet rrugore. Përafrimi i kuadrit ligjor me acqui të BE-së, lidhur me shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”: Realizueshmëria **30%, ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.
- 2.2.29” Hartimi dhe miratimi i projekteve për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve të udhëtarëve dhe autobuseve të shërbimit të transportit publik vendor”: Realizueshmëria **40%, ngjyra jeshile**, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.
- 2.2.32 “Studimi për mekanizmin e Fondit Social dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel bashkie/qarku si edhe gjithë aktorëve në përdorimin efektiv të Fondit Social”: Realizueshmëria **100%, ngjyra jeshile**.
- 2.2.33 “Plotësimi i kuadrit rregullator për prokurimin e shërbimeve sociale (manual dhe udhëzues) dhe bashkëpunimin me aktorë publikë e private”: Realizueshmëria **100%, ngjyra jeshile**.
- 2.2.34 “Mbështetja për fuqizimin e NJVNR-ve për menaxhimin e rasteve në mënyrë graduale në të gjitha njësitë vendore”: Realizueshmëria **100%, ngjyra jeshile**.
- 2.2.35 “Rritje kapacitetesh për stafet vendore për menaxhimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve, përfshirë nënkontraktimin e kujdesit social bazuar në modele, sigurimin e cilësisë

dhe inspektimin”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.36 “Identifikimi dhe planifikimi i shërbimeve të nevojshme në nivel bashkie e qarku për gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe PAK (shërbime të specializuara)”: Realizueshmëria 80%, ngjyra jeshile.

2.2.37 “Ngritja e shërbimeve të specializuara në mbështetje të reformës PAK dhe përmirësimi i aksesit fizik në këto shërbime, shoqëruar me paketën për referim dhe ofrim të rehabilitimit, si edhe riaftësimin e tyre”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.38 “Mbështetje dhe bashkëpunimi proaktiv me SHSSH, AKPA për aktivizimin e të përfituesve të NE-së në moshë pune dhe referimin në shërbime sociale”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.39 “Ngritje e kapaciteteve për stafet vendore për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe protokollat përkatëse, koordinim me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve”: Realizueshmëria 33%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.40 “Ngritja dhe përdorimi i sistemit të mbledhjes sistematike të të dhënave në lidhje me strehimin social në disa bashki pilot”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.41 “Hartimi i planeve të strehimit social dhe monitorimi periodik i zbatimit të tyre”: Realizueshmëria 49%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.41.1 Rritja e mbulimit të programeve të strehimit social”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.42. “Hartimi i metodologjisë të ndërhyrjes dhe procedurave standarde për ndërhyrjen në rast zjarri dhe fatkeqësie natyrore”: Realizueshmëria 50%, ngjyra portokalli, masa ndodhet mbrapa afatit të realizimit.

2.2.42.1 “Identifikimi dhe hartëzimi i proceseve në të gjitha nivelet e strukturave të MZSH-së me qëllim propozimin e sistemeve inovative për lehtësimin e procesve të punës, monitorimin në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve online për qytetarët”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.43 “Identifikimi i projekteve që do të mundësonin digjitalizimin e shërbimit të MZSH-së lidhur me thirrjet e adresuara të numri unik 128”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.44 “Hartimi i dokumenteve të strategjisë për zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor (plani kombëtar i emergjencave civile dhe plan operacional)”: Realizueshmëria 35% ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.45 “Hartimi i planit vendor për emergjencat civile”: Realizueshmëria 48%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.46 “Krijimi i bazës së të dhënave në nivel vendor për emergjencat civile”: Realizueshmëria 67%, ngjyra jeshile.

2.2.47 “Forcimi i strukturës vendore për mbrojtjen civile”: Realizueshmëria 26%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.2.48 “Trajnimi i punonjësve të NJVV dhe grupeve vullnetare komunitare për përballimin e situatave të fatkeqësive natyrore”: Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.

2.2.49 “Hartimi i akteve nënligjore në plotësim të ligjit të ri të Policisë Bashkiake”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

2.2.50” Plotësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike”: Realizueshmëria 50% ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.2.51 “Nxitja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe trajnimi i punonjësve të policisë bashkiake”: Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.

2.3.1 “Hartëzim i të gjithë standardeve të shërbimeve të ofruara nga bashkitë, duke i ndarë sipas llojit të standardeve (teknike, administrative, shërbimi)”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

2.3.2 “Hartimi i metodologjisë për vendosjen e standardeve kombëtare minimale për shërbime të përzgjedhura”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.3.3 “Prioritizim i një liste standardesh minimale kombëtare dhe koordinim i procesit për vendosjen e tyre”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

2.3.4” Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të arsimit parashkollor dhe kostimi i tyre”: Realizueshmëria 30%, ngjyrë portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.3.5” Përcaktimi i kostove për njësi për shërbimet e kujdesit social si edhe hartimi i standardeve të reja dhe riorganizimi i standardeve ekzistuese në fushën e shërbimit të kujdesit social”: Realizueshmëria 50%, jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

2.3.6” Hartimi dhe miratimi i paketës së plotë të standardeve minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve UKN”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.3.7 “Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimit të mbetjeve dhe kostimi i tyre”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.3.8 “Studim fizibiliteti për standardet minimale kombëtare për ofrimin e shërbimeve të transportit publik vendor dhe politikat sociale (tarifat e lehtësuara)”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

2.3.9” Hartimi dhe miratimi i standardeve për ndërtimin dhe funksionimin e stacioneve multimodale të mjeteve të transportit publik vendor”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

2.4.1” Ndërtimi i një sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm”: Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.

2.4.2 “Përshtatja e kuadrit normativ për ndërtimin e një sistemi të bazuar në performancë”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa në proces realizimi.

2.4.3 “Hartimi i udhëzuesve për ngritjen e Njësive të Performancës në nivel bashkie dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e tij”: Realizueshmëria 99% ngjyra jeshile.

QP3.

3.1.1 “Vlerësim i praktikave, nevojave dhe gatishmërisë digjitale të bashkive dhe publikut”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

3.2.1” Implementimi i shërbimeve elektronike në platformën e-Albania”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

3.2.2 “Implementimi i sistemit të trajtimit dhe menaxhimit të aplikimeve”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në process realizimi.

3.2.3” Krijimi i sistemit elektronik të rekordeve dhe dokumenteve elektronike”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në process realizimi.

3.2.4” Implementimi i sistemit e-inspektimi”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

3.2.5” Sistemi e-gjyba për Policinë Bashkiake”: Realizueshmëria 100% ngjyra jeshile.

3.2.6 “Ngritja e sistemit online të taksave dhe tarifave vendore”; Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

3.2.7 “Ngritja e sistemit financiar për menaxhimin e kontabilitetit dhe magazinës”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

3.2.8 “Implementimi i faqeve zyrtare (website) të reja dhe unifikuara të çdo bashkie”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli masa ndodhet në proces realizimi.

3.2.9” Implementimi i sistemit për menaxhimin e punëve publike”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

3.2.10 “Ngritja e sistemit të akteve elektronike të Këshillit Bashkiak dhe botimit të tyre”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

3.2.11 “Ngritja e infrastrukturës hardëare të qendëruar për sistemet TIK të pushtetit vendor”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

QP4.

4.1.1 “Rritja e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme”: Realizueshmëria 51%, ngjyra jeshile.

4.1.2 “Popullimi dhe përditësimi i kadastrës fiskale”: Realizueshmëria 51%, ngjyra jeshile.

4.1.3 “Miratimi i ligjit dhe kuadrit rregullator për taksën e pasurisë së paluajtshme”: Realizueshmëria 60%, ngjyra jeshile.

4.1.4 “Ngritja e një sistemi monitorimi për taksën e pasurisë së paluajtshme”: Realizueshmëria 51%, ngjyra jeshile.

4.1.6 “Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore": Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

4.1.7 “Hartimi i Udhëzimit dhe mënyrën e përlllogaritjes së ndarjes midis njësive të vetëqeverisjes vendore së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale”: Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile. 70%.

4.1.8 “Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme (ndërlidhja) në sistemin informatik të administratës tatimore qendrore për të mundësuar identifikimin e plotë të rezidencës së tatimpaguesve”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

4.1.9 “Ndryshimi i kuadrit ligjor për të reflektuar rritjen e pjesës takuese të njësive të vetëqeverisjes vendore nga renta minerare nga niveli aktual prej 5% në 8%”: Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

4.1.10 “Ngritja e një sistemi raportimi dhe rakordimi midis administratës qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për masën e rentës minerare të pagueshme”: Realizueshmëria 80 %, ngjyra jeshile.

4.1.11 “Studim fizibiliteti për ndarjen e të ardhurave nga tatime të tjera kombëtare (taksat e përbashkëta)”: Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli masa ndodhet në proces realizimi.

4.1.14 “Studimi i fizibilitetit për Sistemin MIS të unifikuar të tatimeve (TAIS), përfshirë modul për menaxhimin financiar të aseteve”: Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

4.2.1 “Integrimi i transfertave specifike në transfertën e pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) për menaxhimin e funksioneve. Transferimi i granteve të përgjithshme dhe granteve sektoriale”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

4.2.2 “Hartimi i një studimi mbi funksionet vendore që financohen me transferata të kushtëzuara, nevojat e bashkive për financim dhe mundësitë e financimit”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli masa ndodhet në proces realizimi.

4.2.3” Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me grante të kushtëzuara të funksioneve vendore apo projekteve kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

4.3.1 “Financimi nëpërmjet huamarrjes së njësive të qeverisjes vendore”: Realizueshmëria 70%, ngjyra jeshile.

4.4.1 “Studimi i fizibilitetit për AFMIS vendor: përcaktimi kërkesave funksionale dhe proceseve të biznesit”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

4.4.2 “Hartimi i konceptit të detajuar për AFMIS dhe detajimi i zgjidhjes informatike dhe termat e referencës për ndërtimin e sistemit”: Realizueshmëria 10%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

4.4.9 “Vlerësimi i kostove dhe miratimi i një akti ligjor (VKM) për regjistrimin dhe dhënien pa pagesë me modalitete të lehtësuara të informacionit tek NJVV-të lidhur me asetet publike vendore dhe vendosjen e barrave siguroese mbi pronat”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

4.4.11 “Përfshirja në SIFQ e kërkesave të NJVV për kontabilitetin rritës, menaxhimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe raportet financiare periodike dhe vjetore. Përkon me procesin e zhvillimit /zgjerimit të mëtejshëm të SIFQ.”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

4.4.12 “Vlerësimi i aspekteve teknike për ndarjen e llogarive vendore në Llogari të Unifikuar të thesarit”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

4.4.13 “Identifikimi (ndarja) e llogarive vendore”: Realizueshmëria 0% ngjyra e kuqe masa nuk ka nisur ende të realizohet.

QP5.

5.1.1 “Konsolidim i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendosjet ligjore dhe administrative në marrëdhëniet me qeverisjen qendrore (kompetencat e Këshillit Bashkiak, konsultimi publik dhe vendimarrja e qytetarit)”: Realizueshmëria 20%, ngjyra portokalli, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

5.1.2 “Ndërtimi i një mekanizmi nxitës për rritjen e efikasitetit të Këshillave Bashkiakë duke pasur parasysh performancën e tij, komisionet bashkiake dhe aspekte të tjera lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, duke marrë në konsideratë integrimin me bazë gjinore”: Realizueshmëria 0%, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

5.1.3 “Forcimi i kapaciteteve të Këshillave Bashkiak dhe inkurajimi i shkëmbimit të praktikave të mira mbi transparencën, llogaridhënien dhe vendimarrja mbi bazën e parimit të subsidiaritetit”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

5.2.1 “Koordinimi dhe bashkërendim me NJVV për hartimin e planeve të integritetit dhe Kodit të Sjelljes”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

5.3.1 “Forcimi i rolit të Njësive të BE-së për të koordinuar dhe marrë pjesë në proceset e zhvillimit të politikave bashkiake”: Realizueshmëria 50%, ngjyra jeshile, masa ndodhet në proces realizimi.

5.3.2 “Shtrirja e proceseve të integritetit në BE përtej Njësive të BE-së, duke siguruar përfshirjen dhe kontributin e duhur të gjithë administratës vendore”: Realizueshmëria 50% ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

5.3.3 “Zhvillimi i udhëzimeve ndihmuese për administratën vendore lidhur me agjendën e integritetit evropian në nivel vendor”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

5.3.4 “Krijimi i një sistemi monitorimi dhe raportimi për projektet e zbatuara nga NJVV”: Realizueshmëria 100%, ngjyra jeshile.

QP6.

6.1.1 “Vlerësim kombëtar i nevojave për trajnim dhe trajnime të vazhdueshme bazuar në vlerësimin për trajnim”: Realizueshmëria 25%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

6.1.2” Krijimi i një strukture të dedikuar të trajnimit (Akademia e Trajnimit) të administratës në nivel vendor, përfshirë të zgjedhurit vendor”: Realizueshmëria 30%, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

6.1.3 “Analiza e nivelit të pagave dhe rishikimi (rritja) e nivelit të pagave të nëpunësve në NJVV, për të siguruar qëndrueshmëri të nëpunësve ekzistues dhe tërheqjen e nëpunësve të rinj të talentuar dhe profesionistë”: Realizueshmëria **0%**, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.1.4 “Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve publikë përmes zbatimit të programeve të trajnimit dhe internship-it, dedikuar nëpunësve civilë të rinj”: Realizueshmëria **90%**, ngjyra jeshile.

6.1.5 “Vlerësim për përmirësimin e funksionaliteteve të platformës “Administrata.al”, për të reflektuar nevojat e institucioneve përfshirë dhe nivelin vendor për një menaxhim të unifikuar të burimeve njerëzore”: Realizueshmëria **0%**, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.1.6 “Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për përdorimin e platformës “Administrata.al” për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave për trajnim të stafit në nivel qendror dhe vendor dhe hartimi i planit të trajnimeve për NJVV mbi përdorimin e portalit “Administrata.al”: Realizueshmëria **75%**, ngjyra jeshile.

6.1.7 “Ngritja e kapaciteteve të Njësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të NJVV-ve për përdorimin e platformës "Administrata.al" përmes trajnimeve dhe asistimit përmes help-desk të ngritur pranë DAP”: Realizueshmëria **30%**, ngjyra portokalli, masa në proces realizimi.

6.1.8 “Rritja e përdorimit të funksionaliteteve të platformës "Administrata.al", për menaxhimin e burimeve njerëzore nga ana e NJVV përfshirë dhe raportimin periodic” Realizueshmëria **51%**, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit.

6.1.9 “Hartimi dhe integrimi i kuadrit/kornizës së kompetencave për burimet njerëzore të NJVV në planin e trajnimit të ASPA-ës”: Realizueshmëria **75%**, ngjyra jeshile.

6.1.10 “Hartimi i strategjisë/planit për zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të NJVV-ve në 61 bashkitë dhe 12 këshillat e qarqeve”: Realizueshmëria **75%**, ngjyra jeshile.

6.1.11 “Krijimi i modeleve të matjes së performancës në nivel vendor bazuar në rezultate krahasimore”: Realizueshmëria **75%**, ngjyra jeshile.

6.2.1 “Identifikim dhe vlerësimi i marrëdhënieve dhe roleve të institucioneve qendrore dhe vendore në mbështetje të qeverisjes vendore”: Realizueshmëria **0%**, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.2.2 “Forcimi i kapaciteteve të Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe AMVV për vlerësim, monitorim dhe zbatim të agjendës së decentralizimit”: Realizueshmëria **100%**, ngjyra jeshile.

6.2.3 “Forcimi i rolit të Grupit Tematik të Decentralizimit në diskutimin e agjendës së decentralizimit dhe koordinimin me donatorët”: Realizueshmëria **0%**, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.2.4 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të funksionimit të Këshillit Konsultativ për rritjen e rolit të tij proaktiv nën dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore”: Realizueshmëria **20%**, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

6.2.5 “Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ në përforcimin e dialogut ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore për koordinimin e veprimtarive dhe analizën e legjislacionit për shqyrtim, si dhe rritja e rolit të qeverisjes vendore në procesin konsultues të projektakteve lidhur me standardet e shërbimeve vendore.”: Realizueshmëria **50%**, ngjyra jeshile, masa e realizuar për vitin e parë të planit të veprimit

6.3.1 “Vlerësimi i gatishmërisë për decentralizim të mëtejshëm sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta bashkiake”: Realizueshmëria **100%**, ngjyra jeshile.

6.3.2 “Vlerësim dhe ridimensionim të rolit të qarqeve në kuadër të zhvillimit ndër-rajonal, nder to identifikimi i fushave me potencial për ekonomi shkalle”: Realizueshmëria **0%**, ngjyra e kuqe, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.4.1 “Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator të institucionit të prefektit”: Realizueshmëria **20%**, ngjyra portokalli, masa ndodhet në proces realizimi.

6.4.2” Forcimi i monitorimit dhe rritja e bashkëpunimit të institucionit të prefektit me degët territoriale, përfshirë edhe rolin në monitorimin e standardeve kombëtar”: Realizueshmëria **0%**, **ngjyra e kuqe**, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.5.1 “Ofrimi dhe ndarje e njohurive/eksperiencave nga shoqatat”: Realizueshmëria **20%**, **ngjyra portokalli**, masa ndodhet në proces realizimi.

6.5.2 “Ngritja / rijetëzimi pranë shoqatave i forumeve profesionale në ndihmë të ndërveprimit mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore”: Realizueshmëria **0%**, **ngjyra e kuqe**, masa nuk ka nisur ende të realizohet.

6.5.3 “Konsolidimi i mekanizmit të Konkursit të Praktikave të Mira dhe inkurajimi me çmime”: Realizueshmëria **0%**, **ngjyra e kuqe**, masa nuk ka nisur ende të realizohet.